



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**

**Nr. 4, datë 1.2.2017**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të Nënkreut II të Kreut VI të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare me ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.
3. Bankat dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të cilat në përputhje me ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” janë institucione mbizotëruese të një grupi bankar ose financiar, deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, marrin masat dhe krijojnë kushtet e nevojshme për zbatimin e kërkesave të rregullores së miratuar sipas këtij vendimi.
4. Të dhënat e hartuara mbi baza vjetore, për vitin 2017, do të raportohen në Bankën e Shqipërisë sipas kërkesave të rregullores së miratuar sipas këtij vendimi.
5. Me hyrjen në fuqi të rregullores së miratuar me këtë vendim, shfuqizohet rregullorja “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 68, datë 28.07.2005.
6. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në 1 dhjetor 2017.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis ÇIBUKU**

**Gent SEJKO**

## **KREU I TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, rregullave dhe kërkesave rregullatore për realizimin e mbikëqyrjes së konsoliduar, për qëllime të administrimit të rrezikut që rrjedh nga grupi bankar dhe grupi financiar.

### **Neni 2 Subjektet**

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat në përputhje me ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, janë institucione mbizotëruese të një grupi bankar ose të një grupi financiar, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në mënyrë të përshtatshme për grupin financiar dhe institucionet mbizotëruese të tij, sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë në përputhje me përbërjen, madhësinë dhe kompleksitetin e grupit.

### **Neni 3 Baza juridike**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:

- a) nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja ”c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe
- b) nënkreut II të Kreut VI të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që më poshtë do të quhet “ligji për bankat”.

### **Neni 4 Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat, si dhe në aktet e tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
  - a) “Institucion mbizotërues” - është banka mbizotëruese ose shoqëria financiare zotëruese në një grup, siç përcaktohen në ligjin për bankat dhe që licencohen nga Banka e Shqipërisë;
  - b) “Institucion i varur” – është çdo subjekt financiar që bën pjesë në të njëjtin grup bankar ose financiar, që nuk konsiderohet institucion mbizotërues, veprimtaria e të cilit përfshihet për efekt të kryerjes së mbikëqyrjes së konsoliduar;

- c) “Perimetri i rrezikut” - është tërësia e rreziqeve materiale, ndaj të cilave ekspozohet grupi bankar ose financiar, të cilat vijnë nga një subjekt i veçantë i grupit ose nga subjekte të lidhura me të, apo nga mjedisi makrofinanciar;
- d) “Interes i pakicës” - është shuma (madhësia) e kapitalit bazë të nivelit të parë (aksione të zakonshme) të një anëtarit të grupit bankar, që i atribuohet personave fizikë ose juridikë, të cilët nuk janë objekt i konsolidimit të grupit bankar;
- e) “Grup financiar” – është:
  - i) një grup, në të cilin një subjekt financiar jobankë, i licencuar nga Banka e Shqipërisë, ka pjesëmarrje influencuese ose kontrollon një bankë me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kur totali i bilancit të kësaj banke nuk është më i madh se investimet e tjera të kryera nga ky subjekt financiar jobankë;
  - ii) një grup, në të cilin një shoqëri financiare zotëruese me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, ka përqindje influencuese ose kontrollon një apo më shumë banka ose subjekte financiare jobanka me seli brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.


## **KREU II GRUPI BANKAR**

### **Neni 5 Metoda dhe shtrirja e konsolidimit**

1. Institucioni mbizotërues, për konsolidimin e pasqyrave financiare, përdor metodat e konsolidimit të përcaktuara në “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare”<sup>1</sup>.
2. Metoda e përdorur për konsolidimin e pasqyrave financiare të të gjithë anëtarëve të grupit bankar, konsideron respektivisht:
  - a) përfshirjen e aktiveve dhe pasiveve të anëtarëve të grupit bankar, rresht për rresht në bilancin e konsoliduar, pasi më parë të jenë kryer zbritjet e plota të tepricave që përfaqësojnë marrëdhënien midis anëtarëve të grupit bankar (përfshirë edhe llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme);
  - b) përfshirjen e zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve të anëtarëve të grupit bankar, rresht për rresht në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të konsoliduar, pasi më parë të jenë kryer zbritjet e plota të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të fitimeve/humbjeve që kanë lidhje me transaksionet brenda grupit bankar; si dhe
  - c) zbritjet e investimeve në pjesëmarrje të institucionit mbizotërues dhe të pjesës së kapitalit, që institucioni mbizotërues zotëron tek çdo anëtar i grupit bankar.
3. Institucioni mbizotërues përcakton dhe vlerëson perimetrin e rrezikut të grupit bankar, duke marrë në konsideratë profilin e rrezikut të tij mbi baza individuale dhe mbi baza të konsoliduara, së bashku me subjektet përbërëse të grupit bankar, si dhe duke vlerësuar

<sup>1</sup> Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 95, datë 24.12.2008.

veprimtaritë e subjekteve përbërëse të grupit, në masën që ato mund të kenë një ndikim të rëndësishëm (material) në reputacionin apo gjendjen financiare të grupit bankar.

4. Institucioni mbizotërues përjashton nga konsolidimi i grupit bankar institucionet e varura, pjesë të grupit, në rastin kur këto janë:
  - a) shoqëri të sigurimit dhe risigurimit, në rastin e konsolidimit sipas metodës së përfshirjes së plotë;
  - b) shoqëri të administrimit të fondeve të investimit dhe të fondeve të pensionit, në rastin e konsolidimit sipas metodës së përfshirjes të plotë; dhe
  - c) subjekte financiare, totali i bilancit të të cilave nuk tejkalon 1%  totalit të bilancit të institucionit mbizotërues.

## **Neni 6**

### **Mbikëqyrja e konsoliduar cilësore**

1. Mbikëqyrja e konsoliduar cilësore përfshin vlerësimin dhe kontrollin e të gjitha rreziqeve që nuk konsiderohen nga mbikëqyrja e konsoliduar sasiore, kryesisht:
  - a) të rrezikut që rrjedh nga krijimi i strukturës së përgjithshme të grupit bankar, duke përfshirë edhe (pa)mjaftueshmërinë e strukturave që sigurojnë komunikimin dhe koordinimin nga qendra në periferi të grupit bankar dhe anasjelltas (simetrinë e informacionit);
  - b) të përshtatshmërisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të administrimit të rreziqeve;
  - c) të rrezikut operacional, strategjik, reputacional dhe ligjor;
  - d) të përputhshmërisë së veprimtarive, organizimit dhe drejtimit të grupit bankar me aktet e brendshme të tyre;
  - e) të rrezikut që rrjedh nga faktorë të mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm, ku ushtron veprimtarinë institucioni mbizotërues, si edhe çdo subjekt përbërës i grupit bankar;
  - f) të rrezikut të përqendrimit dhe të transaksioneve të rëndësishme brenda grupit (TRBG), siç përcaktohet në Aneksin 1 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 7**

### **Mbikëqyrja e konsoliduar sasiore**

1. Mbikëqyrja e konsoliduar sasiore përfshin vlerësimin dhe kontrollin, kryesisht, të pozicionit të konsoliduar të kapitalit rregullator, të mjaftueshmërisë së kapitalit, të ekspozimeve të mëdha, të pozicioneve të hapura valutore, si dhe të investimeve në kapitalin e institucioneve jofinanciare të grupit bankar.
2. Institucioni mbizotërues përgatit dhe paraqet pranë Bankës së Shqipërisë pasqyrat e konsoliduara financiare, në përputhje me nenin 85 të ligjit për bankat.

### **KREU III**

#### **KAPITALI RREGULLATOR, EKSPOZIMI I MADH, POZICIONI I HAPUR VALUTOR DHE INVESTIMI NË KAPITALIN E INSTITUCIONEVE JOFINANCIARE PËR GRUPIN BANKAR**

##### **Neni 8 Të përgjithshme**

1. Institucioni mbizotërues respekton në çdo kohë kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet e tjera rregullative të Bankës së Shqipërisë, mbi nivelin e kapitalit rregullator, të raportit minimal të kërkuar të mjaftueshmërisë së kapitalit, të ekspozimit të madh, të pozicionit të hapur valutor, si edhe të investimit në kapitalin e institucioneve jofinanciare.
2. Në zbatim të kërkesave të paragrafit 1 të këtij neni, kërkesat e akteve të tjera rregullative, zbatohen përshtatshëm për një grup bankar, duke e konsideruar grupin bankar si një subjekt të vetëm, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore.

##### **NËNKREU I Kapitali rregullator i grupit bankar**

##### **Neni 9 Niveli i kërkuar i kapitalit rregullator**

1. Institucioni mbizotërues siguron që kapitali rregullator i llogaritur mbi baza të konsoliduara, të jetë në çdo kohë më shumë se totali i:
  - a) kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritur si totali i ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me rrezikun, të shumëzuara me 12%;
  - b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuara me 1.5;
  - c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuar në kreun VIII të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuara me 1.5.

##### **Neni 10 Llogaritja e kapitalit rregullator**

1. Kapitali rregullator llogaritet mbi bazën e të dhënave të pasqyrave financiare të konsoliduara të grupit bankar.
2. Kërkesat në lidhje me strukturën, elementet përbërëse të kapitalit rregullator, kufijtë dhe elementet e zbritshme sipas rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”, zbatohen përshtatshëm në llogaritjen e kapitalit rregullator të grupit bankar.

3. Institucioni mbizotërues, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, në rastet që evidentohen interesa të pakicës, do t'i konsiderojë këto interesa si elemente të kapitalit bazë të nivelit të parë të grupit, nëse:
  - a) zbatohet metoda e përfshirjes së plotë nga institucioni mbizotërues; dhe
  - b) institucioni i varur që ka emetuar instrumentin, është një bankë ose çdo institucion që është subjekt i kriterëve rregullatore dhe mbikëqyrëse, të paktën të barasvlershme me ato të Bankës së Shqipërisë për bankat.

## **NËNKREU II**

### **Kërkesat për kapital për grupin bankar**

#### **Neni 11**

##### **Të përgjithshme**

1. Institucioni mbizotërues llogarit kërkesën për kapital për grupin bankar mbi baza të konsoliduara, si shumë të kërkesave për kapital të llogaritura në nivel grupi bankar.
2. Kërkesat e rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” zbatohen përshtatshmërisht për llogaritjen e kërkesave për kapital në nivel grupi bankar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga kjo rregullore.

#### **Neni 12**

##### **Kërkesat për kapital për rrezikun e kredisë**

1. Kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë, për një grup bankar, do të llogaritet duke përdorur metodën standarde në baza të konsoliduara.
2. Kërkesat e rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” për llogaritjen e kërkesave për kapital për rrezikun e kredisë, zbatohen në nivel grupi bankar, duke konsideruar grupin bankar si një subjekt të vetëm.

#### **Neni 13**

##### **Kërkesat për kapital për rrezikun operacional**

1. Kërkesa për kapital për rrezikun operacional për një grup bankar do të llogaritet duke përdorur metodën e treguesit të thjeshtë ose metodën standarde, mbi bazën e të dhënave të konsoliduara.
2. Kërkesat e rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” për llogaritjen e kërkesave për kapital për rrezikun operacional, zbatohen në nivel grupi bankar duke konsideruar grupin bankar si një subjekt të vetëm.
3. Zbatimi i kërkesave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni kërkon që llogaritja e kërkesës për kapital për rrezikun operacional të bëhet duke përdorur të dhënat për të ardhurat neto të grupit bankar.

## **Neni 14**

### **Kërkesat për kapital për rrezikun e tregut**

1. Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut për një grup bankar llogaritet si shumë e kërkesave për kapital, të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” për aktivitetin në librin e tregtueshëm, si edhe të kërkesave për kapital për të gjitha pozicionet (pozicione në librin e tregtueshëm dhe pozicione në librat e bankës) në nivel grupi bankar.
2. Institucioni mbizotërues, në llogaritjen e kërkesave për kapital për rrezikun e tregut, nuk mund të bëjë asnjë netim të pozicioneve të librit të tregtueshëm ose netim të pozicioneve në monedhë të huaj (për rrezikun e kursit të këmbimit) apo netim të pozicioneve në mallra (*commodities*) ndërmjet subjekteve përbërëse të grupit bankar, përveçse nëse ato janë kryer në përputhje me rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

## **NËNKREU III**

### **Ekspozimi i madh, pozicioni i hapur valutor dhe investimi në kapitalin e institucioneve jofinanciare për grupin bankar**

## **Neni 15**

### **Mënyra e llogaritjes së ekspozimit të madh**

1. Ekspozimet e grupit bankar ndaj një personi, apo personave të lidhur ndërmjet tyre, nuk mund të tejkalojnë kufijtë maksimalë të lejuar, të përcaktuar në ligjin për bankat dhe në Rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha”. Kërkesat për llogaritjen e ekspozimit të madh të grupit bankar, zbatohen duke e konsideruar grupin bankar si një subjekt të vetëm.
2. Ekspozimi i një grupi bankar ndaj një personi, ose grupi personash të lidhur ndërmjet tyre, llogaritet mbi bazën e zërave të bilancit dhe jashtë-bilancit në pasqyrat financiare të konsoliduara, si dhe llogaritja e kufijve maksimalë të këtyre ekspozimeve konsideron kapitalin rregullator të grupit bankar, mbi baza të konsoliduara.
3. Në llogaritjen e ekspozimit nga aktiviteti në librin e tregtueshëm, një institucion mbizotërues mund të netojë pozicionet nga libri i tij i tregtueshëm dhe pozicionet nga librat e tregtueshëm të subjekteve të përfshira në llogaritjen e ekspozimit në baza të konsoliduara, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kreun VII “Rreziku i Tregut”, të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
4. Banka e Shqipërisë, pa rënë ndesh me mënyrën e llogaritjes dhe kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, mund të kërkojë përfshirjen në llogaritjen e ekspozimit të madh të grupit bankar, të ekspozimeve ndaj subjekteve të përjashtuara nga konsolidimi, me qëllim llogaritjen e plotë të ekspozimit të madh të grupit.

## **Neni 16**

### **Mënyra e llogaritjes së pozicionit të hapur valutor**

1. Mënyra e llogaritjes së pozicionit të hapur valutor dhe kërkesat për kufijtë e ekspozimit të parashikuara në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura

valutore”, zbatohen për grupin bankar, duke e konsideruar grupin bankar si një subjekt të vetëm.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, për kursin e këmbimit të monedhave të cilat nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë, si referencë përdoret kursi i publikuar në faqen zyrtare: <http://www.reuters.com>.

### **Neni 17**

#### **Investimet në kapitalin e institucioneve jofinanciare**

1. Investimet e grupit bankar në kapitalin e shoqërive tregtare, që nuk janë banka apo institucione financiare, janë subjekt i dispozitave të nenit 70 të ligjit për bankat.
2. Kërkesat për kufijtë e investimit në kapitalin e subjekteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, llogariten bazuar në kapitalin rregullator të grupit bankar të llogaritur mbi baza të konsoliduara, dhe në vlerën e investimit bazuar në pasqyrat financiare të konsoliduara.

### **KREU IV**

#### **KËRKESAT RAPORTUESE**

### **Neni 18**

#### **Të përgjithshme**

1. Institucioni mbizotërues paraqet në Bankën e Shqipërisë, brenda 60 ditëve pas datës së mbylljes së periudhës raportuese, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të dhënat sipas anekseve bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.
2. Institucioni mbizotërues siguron transparencën e nevojshme në hartimin dhe paraqitjen e pasqyrave financiare, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duke paraqitur edhe informacione shtesë për të qartësuar pasqyrat financiare të konsoliduara, nëse kërkohen nga Banka e Shqipërisë.
3. Institucioni mbizotërues paraqet pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të dhënat, sipas përmbajtjes dhe frekuencës së përcaktuar në anekset bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje.
4. Institucioni mbizotërues, në rast të një kërkesë të veçantë nga Banka e Shqipërisë, harton raportet e përcaktuara në këtë nen bazuar në të dhënat për situatën deri në një datë dhe brenda një afati të përcaktuar.

### **Neni 19**

#### **Paraqitja e informacionit nga subjektet e grupit bankar për konsolidimin**

1. Institucioni mbizotërues siguron që subjektet përbërëse të grupit bankar (institucionet e varura), të paraqesin të gjithë informacionin e nevojshëm në zbatim të kërkesave për mbikëqyrjen mbi baza të konsoliduara, dhe mbi bazën e tyre, përgatit dhe paraqet në përputhje me detyrimet ligjore dhe rregullative, raportet dhe informacionet e kërkuara nga ligji për bankat dhe nga aktet nënligjore përkatëse.



2. Informacioni i specifikuar në pikën 1 të këtij neni përfshin në veçanti:

- a) raportin e kontrollit të brendshëm, raportin e ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe planin e biznesit, nëse ekziston;
- b) raportet financiare tremujore (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);
- c) një listë të aksionerëve ose zotëruesve të interesave pjesëmarrëse dhe të drejtave të tjera;
- d) një listë të anëtarëve të këshillit drejtues dhe drejtorisë së institucionit të varur, specifikimin nëse konsiderohen të varur apo të pavarur, si edhe informacion të detajuar mbi anëtarësimin e tyre në këshilla drejtues apo drejtori të subjekteve të tjera;
- e) informacion të detajuar në lidhje me zërat/elementet e kapitalit (rregullator) të kërkuar për të vlerësuar nëse ata janë në përputhje me karakteristikat dhe kushtet për t'u përfshirë në llogaritjen e kapitalit rregullator mbi baza të konsoliduara;
- f) shumat e investimeve në aksione, interesa ose instrumente të tjerë kapitali tek subjekte të tjera, të cilat janë të nevojshme për të llogaritur zërat që zbriten nga kapitali rregullator, ose detyrimet që kanë të bëjnë me kufijtë në pjesëmarrjet influencuese të grupit bankar jashtë sektorit financiar;
- g) të dhëna të tjera që institucioni mbizotërues kërkon në lidhje me llogaritjen e kërkesave për kapital, në varësi të metodës së përdorur për llogaritjen e kërkesave për kapital mbi baza të konsoliduara;
- h) shumat e ekspozimeve në librin e institucionit mbizotërues dhe në librin e tregtueshëm për klientët individualë dhe për grupet e klientëve të lidhur; dhe
- i) informacione të tjera, të cilat sipas vlerësimit të Bankës së Shqipërisë, mund të jenë të nevojshme për zbatimin e kërkesave për mbikëqyrjen mbi baza të konsoliduara.

## **Neni 20**

### **Raporti mbi strukturën e grupit bankar**

1. Institucioni mbizotërues i paraqet çdo vit Bankës së Shqipërisë raportin mbi strukturën e grupit bankar. Ky raport përmban një listë të subjekteve përbërëse të grupit, të dhëna dhe informacione të veçanta për këto subjekte, si edhe një përshkrim të marrëdhënieve ndërmjet këtyre subjekteve të grupit, siç paraqiten në ditën e fundit të vitit.
2. Të dhënat dhe informacionet e veçanta për subjektet përbërëse të grupit bankar, përmbajnë minimalisht:
  - a) emrin e subjektit, numrin unik identifikues (NUIS), veprimtaritë e subjektit dhe totalin e aktiveve;
  - b) kapitalin aksioner të subjektit, pjesën e kapitalit ose të drejtave të votës që zotëron institucioni mbizotërues, dhe një listë të subjekteve të tjera që kanë pjesëmarrje në këtë subjekt;
  - c) administratorët e subjektit dhe të dhëna/informacione, nëse këta administratorë kanë pozicione drejtuese në subjekte të tjera;
  - d) të dhëna/informacione mbi autoritetin përgjegjës për mbikëqyrjen e çdo subjekti në baza individuale, përfshirë edhe subjektet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
  - e) të dhëna/informacione mbi auditimet e kryera dhe titullin/emrin e ekspertit kontabël të autorizuar;
  - f) një listë të transaksioneve më të shpeshta/zakonshme që subjekti kryen me subjektet e tjera përbërëse të grupit bankar;

- g) çdo informacion shtesë të nevojshëm për të pasqyruar strukturën e grupit bankar dhe lidhjet në grup.
3. Pjesëmarrjet në kapital ndërmjet subjekteve përbërëse të grupit bankar pasqyrohen në formën e një prezantimi skematik, që tregojnë qartë pjesëmarrjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në kapital ose të drejtave të votës, ose të kontrollit të përbashkët, ose ndonjë lidhje tjetër, si rrjedhojë e së cilës institucioni mbizotërues kontrollon ose ushtron një kontroll ose ndikim të rëndësishëm mbi subjektet e tjera përbërëse të grupit bankar.
  4. Raporti mbi strukturën e grupit bankar dorëzohet në Bankën e Shqipërisë brenda datës 30 prill të vitit pasardhës.
  5. Institucioni mbizotërues, në rast të një kërkesë të veçantë nga Banka e Shqipërisë, paraqet një raport mbi situatën deri në një datë të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.
  6. Institucioni mbizotërues njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim në strukturën e grupit bankar dhe për fakte të tjera që janë me rëndësi për mbikëqyrjen mbi baza të konsoliduara.

## **KREU V PROCESI MONITORES DHE MBIKËQYRËS**

### **Neni 21 Kërkesat mbi sistemin e kontrollit të brendshëm**

1. Institucioni mbizotërues, me qëllim sigurimin e zbatueshmërisë efektive të kërkesave të kësaj rregulloreje, dhe në veçanti për zbatimin e kërkesave të rregullores “Për sistemin e kontrollit të brendshëm”:
  - a) miraton dhe zbaton akte të brendshme, si dhe sisteme të kontrollit të brendshëm, struktura ose funksione të cilat sigurojnë mbikëqyrjen mbi baza të konsoliduara të grupit bankar;
  - b) zhvillon një sistem dhe procedura të brendshme për llogaritjen dhe monitorimin e kapitalit rregullator, të kërkesave për kapital dhe për të gjitha kërkesat e tjera për grupin bankar;
  - c) zhvillon një sistem të administrimit të rreziqeve në nivel grupi, për qëllime të mbikëqyrjes mbi baza të konsoliduara.

### **Neni 22 Parimet dhe kriteret e vlerësimit**

1. Banka e Shqipërisë vlerëson grupin bankar mbi baza të konsoliduara, në mënyrë të vazhdueshme, duke zbatuar standarde të kujdesshme për të gjitha veprimtaritë e kryera nga grupi bankar.

2. Banka e Shqipërisë vlerëson nëse rreziqet e grupit bankar administrohen në mënyrë efektive, si dhe ndërmer veprime/masa kur rreziqet që rrjedhin nga grupi bankar dhe subjektet e tjera të lidhura me të, në veçanti rreziku reputacional, ndikon në qëndrueshmërinë e institucionit mbizotërues dhe të sistemit bankar në Shqipëri.
3. Banka e Shqipërisë vlerëson nëse grupi bankar disponon akte të brendshme për drejtimin efektiv, të cilat përfshijnë drejtimin strategjik, strukturën organizative, sistemin e kontrollit, përgjegjësitë e organeve drejtuese dhe të drejtorive, si edhe politikat e shpërblimit.
4. Banka e Shqipërisë vlerëson nëse aktet e brendshme të grupit bankar përcaktojnë qartë kërkesat për ekspertizën e nevojshme që duhet të kenë administratorët dhe drejtuesit e lartë të institucioneve të varura, për të administruar veprimtaritë në mënyrë të sigurt dhe të shëndoshë, si edhe në përputhje me kërkesat rregullative dhe mbikëqyrëse të vendit të origjinës dhe të atij pritës.
5. Banka e Shqipërisë, për realizimin e mbikëqyrjes së konsoliduar, mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet mbikëqyrëse vendase ose të huaja.

### **Neni 23** **Masat mbikëqyrëse**

1. Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, zbaton masat korrigjuese, mbikëqyrëse dhe/ose ndëshkimore të parashikuara në ligjin për bankat.
2. Banka e Shqipërisë vlerëson dhe kufizon gamën e veprimtarive të grupit bankar dhe vendet në të cilat mund të ushtrojë veprimtaritë (duke përfshirë edhe mbylljen e zyrave apo degëve të institucionit mbizotërues në vende të huaja), në rast se:
  - a) cenohet siguria dhe qëndrueshmëria e grupit bankar apo institucionit mbizotërues, për shkak se veprimtaritë kanë ekspozuar grupin bankar apo institucionin mbizotërues ndaj rreziqeve të tepërta dhe/ose nuk administrohen në mënyrë efektive;
  - b) mbikëqyrja nga autoritetet e tjera mbikëqyrëse, të huaja apo vendase, nuk është efektive mbi veprimtaritë e tyre; dhe / ose
  - c) bëhet i pamundur ushtrimi i mbikëqyrjes efektive në bazë të konsoliduar.

**Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës**

**Gent SEJKO**

## Përmbajtja e Anekseve

ANEKSI 1 .....	12
Trajtimi i transaksioneve të rëndësishme brenda grupit .....	12
ANEKSI 2 .....	18
Pasqyrat financiare mbi baza të konsoliduara .....	18
ANEKSI 3 .....	36
Formularët raportues të kërkesave për kapital (COREP) mbi baza të konsoliduara (referuar rregullores “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”) .....	36
ANEKSI 4 .....	46
Formularët raportues për ekspozimet e mëdha mbi baza të konsoliduara (referuar rregullores “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”) .....	46
ANEKSI 5 .....	55
Formularët raportues të kapitalit rregullator mbi baza të konsoliduara (referuar rregullores “Për Kapitalin Rregullator” dhe rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”) .....	55
ANEKSI 6 .....	68
Formularët raportues të pozicioneve të hapura valutore mbi baza të konsoliduara (referuar rregullores “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”) .....	68
ANEKSI 7 .....	74
Formularët raportues për investimet në kapitalin e shoqërive tregtare (referuar rregullores “Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare”) .....	74
ANEKSI 8 .....	78
Tabelat për publikimin e informacionit (referuar rregullores “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”) .....	78

## **ANEKSI 1**

### **Trajtimi i transaksioneve të rëndësishme brenda grupit**

#### **1. Përkufizime**

“Transaksione brenda grupit” konsiderohen të gjitha transaksionet, nëpërmjet të cilave subjektet e rregulluara brenda grupit financiar mbështeten, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, mbi subjekte të tjera brenda të njëjtit grup, ose mbi persona fizikë apo juridikë që lidhen me këto subjekte nëpërmjet “lidhjeve të ngushta”, me qëllim përmbushjen e detyrimeve me natyrë kontraktuale ose jokontraktuale, dhe të detyrimeve që kërkojnë ose jo pagesë.

“Lidhje e ngushtë” konsiderohet situata ku dy ose më shumë persona fizikë apo juridikë, janë të lidhur nëpërmjet pjesëmarrjes influencuese ose kontrollit, siç përcaktohet në ligjin për bankat.

Një transaksion brenda grupit konsiderohet “transaksion i rëndësishëm”, nëse shuma e tij është të paktën sa 5 për qind e kapitalit rregullator në nivel grupi.

#### **2. Llojet/tipet e transaksioneve të rëndësishme brenda grupit (TRBG)**

2.1 Transaksionet e rëndësishme brenda grupit mund të jenë në një nga format e mëposhtme, por jo vetëm:

- a) investime/zotërim i ndërsjellë i aksioneve (*cross shareholdings*);
- b) operacione tregtimi, ku një anëtar i grupit tregon me (ose në emër të) një anëtar tjetër të grupit;
- c) garanci, hua, letër kredi dhe angazhime të tjera jashtë bilancit, që i jepen (ose merren prej) një anëtar tjetër të grupit;
- d) ofrimi i administrimit ose i shërbimeve të tjera (për shembull, shërbimet e *back-office*, shërbimet e fondeve të pensionit);
- e) ekspozimi ndaj aksionerëve kryesorë (duke përfshirë huatë dhe ekspozimet jashtë bilancit, si angazhimet dhe garancitë);
- f) ekspozimi që rrjedh si rezultat i vendosjes së mjeteve të klientëve tek anëtarë të tjerë të grupit;
- g) transaksionet e blerjes, shitjes ose dhënies me qira të mjeteve/detyrimeve me anëtarë të tjerë të grupit;
- h) transaksione për të zhvendosur ekspozimet me rrezik ndaj palëve të treta, midis anëtarëve që përbëjnë grupin financiar;
- i) transferimi i rrezikut nëpërmjet sigurimit ose risigurimit;
- j) transaksionet e derivativëve;
- k) komisionet brenda grupit që lidhen me kontratat e shpërndarjes (*distribution*).

#### **3. Monitorimi dhe administrimi i TRBG-ve**

3.1 Këshilli drejtues dhe/ose organet drejtuese të institucionit mbizotërues miratojnë një politikë për monitorimin dhe administrimin e TRBG-ve, e cila përcakton kërkesat që duhet të zbatohen nga institucioni mbizotërues në mënyrë të vazhdueshme.

3.2 Politika përcakton proceset dhe sistemet, që mundësojnë identifikimin, vlerësimin dhe raportimin në mënyrë efektive të TRBG-ve, duke mundësuar vlerësimin e saktë të rrezikut që buron nga këto transaksione.

3.3 Këshilli drejtues dhe/ose organet drejtuese të institucionit mbizotërues, rishikojnë politikën për monitorimin dhe administrimin e TRBG-ve, të paktën një herë në vit.

3.4 Politika për monitorimin dhe administrimin e TRBG-ve përfshin minimalisht:

- a) një sistem të rishikimit dhe raportimit në këshillin drejtues dhe/ose organet drejtuese të TRBG-ve, në mënyrë që të mundësojë kuptim më të mirë të madhësisë dhe të rrezikut që buron prej tyre;
- b) kufijtë e ekspozimeve maksimale të lejueshme, sipas dispozitave të ligjit për bankat dhe të rregullores “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”;
- c) kërkesën nëpërmjet së cilës, institucioni mbizotërues i adreson rreziqet që burojnë nga TRBG-të në të njëjtën mënyrë siç do të trajtonte rreziqet nga ekspozimet me palë të treta (jashtë grupit);
- d) kërkesën nëpërmjet së cilës, termat, kushtet dhe standardet e kreditimit për transaksionet brenda grupit, të jenë kryesisht të njëjta me ato që mbizotërojnë në atë kohë edhe për transaksione të krahasueshme me palë të treta (jashtë grupit);
- e) përcaktime lidhur me mekanizmin e transferimit të çmimit, të cilat duhet të sigurojnë përputhshmëri me parimin e “kryerjes së transaksioneve në mënyrë të paanshme”;
- f) procedura për zgjidhjen e çdo konflikti interesi që mund të rrjedhë nga TRBG-të;
- g) përcaktime lidhur me transaksionet me palë të treta (jashtë grupit), por që kryhen për përfitim të subjekteve përbërëse të grupit, duke konsideruar parimin që institucioni mbizotërues nuk duhet të hyjë në transaksione me palë të treta, me qëllim mbështetjen e veprimtarisë së njësisë të grupit, nëse këto nuk kryhen në përputhje me parimin e “kryerjes së transaksioneve në mënyrë të paanshme”<sup>2</sup> dhe në përputhje me politikën e transferimit të çmimit;
- h) kërkesën që TRBG-të të kontrollohen rregullisht nga kontrolli i brendshëm i institucionit mbizotërues dhe të verifikohen me përzgjedhje, nga auditorët e jashtëm, për t’u siguruar që TRBG-të:
  - i) janë në përputhje me parimin e “kryerjes së transaksioneve në mënyrë të paanshme”;
  - ii) nuk ndikojnë negativisht në gjendjen e institucionit mbizotërues;
  - iii) nuk kryhen për të transferuar mjete me cilësi të ulët;
  - iv) nuk janë një instrument për transferim të parregullt të kapitalit/të të ardhurave tek njësitë e grupit;
- i) mekanizmin për të siguruar që TRBG-të nuk çojnë në shkeljen ose shmangien e çdo kërkesë rregullatore, statutore ose të përputhshmërisë fiskale.

3.5 Këshilli Drejtues dhe/ose organet drejtuese të institucionit mbizotërues miratojnë kushtet, në rastet kur për një TRBG synohet të zbatohen kushte të ndryshme nga ato që do të zbatoheshin në përputhje me kushtet mbizotëruese të tregut, për transaksione të ngjashme me palë të treta jashtë grupit. Këto kushte duhet të jenë plotësisht të justifikuara dhe

---

<sup>2</sup> Parimi i “kryerjes së transaksioneve në mënyrë të paanshme” në transferimin e çmimit midis subjekteve të grupit nënkupton që çmimi i caktuar nga njëra palë e lidhur për palë tjetër, për një produkt të caktuar, do të jetë i njëjtë siç do të ishte nëse palët nuk do të ishin të lidhura. Çmimi për një transaksion të tillë do të ishte sa çmimi i atij transaksioni në treg.

qartësisht të dokumentuara nga institucioni mbizotërues dhe vihen në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, ose raportohen sa herë që kërkohen prej saj.

- 3.6 Institucioni mbizotërues nuk blen ose shet aktive të cilësisë së ulët tek njësitë e tjera të grupit, si dhe një aktiv i cilësisë së ulët nuk pranohet si kolateral për një kredi, për një garanci, për një letër kredi, apo për çdo instrument tjetër të ngjashëm, të lëshuar në emër të një anëtarë të grupit. Institucioni mbizotërues duhet të sigurojë që transaksionet me aktivet e cilësisë së ulët nuk kryhen për qëllime të fshehjes së humbjeve, apo të “rregullimit” të bilancit;
- 3.7 Institucioni mbizotërues siguron vendosjen e sistemeve dhe të kontrolleve të mjaftueshme për identifikimin, monitorimin, administrimin dhe rishikimin e rreziqeve që burojnë nga TRBG-të.

#### **4. Sistemet e raportimit të brendshëm**

- 4.1 Institucioni mbizotërues, në sistemin e informimit të administratorëve të tij, përfshin edhe raportimin e TRBG-ve, i cili përmban minimalisht të dhënat që kërkohen në pikën 8 të këtij aneksi.
- 4.2 Banka e Shqipërisë mund të kërkojë, në çdo kohë, nga institucioni mbizotërues raporte të ndryshme për TRBG-të.

#### **5. Mbështetja e institucionit mbizotërues për grupin**

- 5.1 Institucioni mbizotërues mund të mbështesë veprimtarinë e grupit, për sa kohë ajo është në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore. Institucioni mbizotërues duhet të ndërmarrë veprimet e nevojshme, për të mos krijuar perceptim të pasaktë lidhur me mbështetjen e tij të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj anëtarëve të grupit, nëse nuk ekzistojnë procedura të qarta ligjore ose rregullative për këtë mbështetje.
- 5.2 Institucioni mbizotërues, kur vlerëson kërkesat për financim (veçanërisht në situata stresi), duhet të konsiderojë çdo angazhim që ka për dhënie likuiditeti ndaj anëtarëve të tjerë të grupit dhe të përgatitet për tërheqje fondesh nga anëtarët e grupit mbi bazën e këtyre angazhimeve. Institucioni mbizotërues duhet të analizojë se si pozicioni i likuiditetit të subjekteve të tjera të grupit, mund të ndikojë pozicionin e tij të likuiditetit, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet transferimit të rrezikut, në rastet kur këto subjekte përballen me mungesë të likuiditetit. Institucioni mbizotërues, në rastet kur anëtarët e grupit mbështeten tek njëri-tjetri për plotësimin e nevojave për likuiditet, vlerëson përcaktimet ligjore, rregullative ose faktorë të tjerë, që mund të kufizojnë aksesin në likuiditet nga institucioni mbizotërues drejt subjekteve të tjera të grupit dhe e kundërta, në rast nevojë.
- 5.3 Institucioni mbizotërues duhet të vendosë kufij të brendshëm për mbështetjen me likuiditet brenda grupit, për të kufizuar mundësinë e transferimit të rrezikut nga anëtarë të tjerë të grupit, në rastet kur ata ndodhen në situatën e mungesës së likuiditetit. Institucioni mbizotërues mund të ndihmojë për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të financimit në nivel grupi, për krijimin e rezervave të likuiditetit dhe për diversifikimin e burimeve të financimit, në rastet e shfaqjes së mungesës së likuiditetit në nivel grupi.

## 6. Shitja e kryqëzuar e produkteve të grupit dhe transparenca ndaj klientit

- 6.1 Institucioni mbizotërues duhet të zbatojë kriteret më të larta të transparencës, kur shet produktet e veta ose të anëtarëve të grupit të klientët e vet, ose tek ata të anëtarëve të tjerë të grupit.
- 6.2 Institucioni mbizotërues, në rastet kur angazhohet për reklamimin/ofrimin e produkteve financiare të subjekteve të tjera të grupit të klientët e tij, duhet të sigurohet që identiteti i shitësit është qartësisht i shprehur dhe i shfaqur në materialet përkatëse të reklamimit, në dokumentacionin shoqërues të produktit dhe që i njëjti standard përdoret kur produkti reklamohet nga personeli/agjentët e tij në degë, në ATM, përmes telefonit, postës elektronike, apo çdo forme/mjeti tjetër komunikimi.
- 6.3 Institucioni mbizotërues, në çdo rast sigurohet që:
- a) klienti mund të dallojë qartësisht rolin dhe përgjegjësinë e institucionit mbizotërues nga ai i shitësit të produktit;
  - b) nuk krijohet perceptimi se produkti është i garantuar apo i mbështetur nga institucioni mbizotërues, nëse nuk ka një marrëveshje formale ligjrisht të vlefshme për këtë qëllim;
  - c) këto produkte nuk kombinohen me produkte të institucionit mbizotërues, në një mënyrë që t'i detyrojë klientët të blejnë produktin e reklamuar; dhe
  - d) kur reklamon apo shpërndan produkte të subjekteve të tjera të grupit, institucioni mbizotërues duhet të zbatojë kuadrin ligjor e rregullativ lidhur me njohjen e klientit, parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit.
- 6.4 Institucioni mbizotërues, në rastet kur subjekte të tjera të grupit shpërndajnë/shesin produktet e tij, sigurohet se:
- a) garantohet një transparencë e plotë për rolin e institucionit mbizotërues dhe të subjektit tjetër të grupit;
  - b) subjekti i grupit nuk kryen ndonjë funksion kyç vendimmarrës të institucionit mbizotërues (siç mund të jetë p.sh. vlerësimi i aftësisë paguese të kredimarrësit) në shpërndarjen e produktit të institucionit mbizotërues, përveçse kur parashikohet ndryshe në një akt nënligjor të Bankës së Shqipërisë dhe mbështetet nga marrëveshjet përkatëse kontraktuale midis palëve;
  - c) zbatimi i kërkesave rregullative lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, është i mundur dhe i plotë.
- 6.5 Institucioni mbizotërues përcakton standarde minimale që duhet të plotësohen nga personeli i tij lidhur me komunikimin dhe transparencën, gjatë shitjes së kryqëzuar të një produkti tek një klient i institucionit mbizotërues<sup>3</sup>. Institucioni mbizotërues gjithashtu sigurohet që informacioni që i jepet klientit është i saktë, për t'i mundësuar klientit të marrë një vendim të mirëinformuar. Karakteristikat, kushtet dhe elementë të tjerë të produktit, përveçse i komunikohen klientit, duhet t'i jepen atij edhe me shkrim, paraprakisht, nëse ai i kërkon, edhe pasi produkti të blihet nga klienti.

---

<sup>3</sup> Zbatimi i këtyre standardeve në praktikë duhet të verifikohet rregullisht. Kur produkti reklamohet dhe shitet përmes kanaleve të tilla si telefoni apo posta elektronike, klientit duhet t'i tregohet në mënyrë të qartë identiteti i telefonuesit/dërguesit të mesazhit duke përfshirë emrin-mbiemrin, pozicionin dhe drejtorinë/departamentin e bankës ku ai punon.



6.6 Institucioni mbizotërues sigurohet që stimujt për personelin ose agjentët ndërtohen në atë mënyrë, që të mos inkurajojnë abuzimet në shitjen e produktit tek klientët. Këta stimuj duhet të përfshijnë edhe mekanizmin e rikthimit të përfitimeve, në rastin e abuzimit me shitjen. Gjithashtu, institucioni mbizotërues nuk duhet të nënshkruajë marrëveshje, ku stimujt monetarë/jomonetarë nga shitja e kryqëzuar e produkteve, i paguhen/jepen direkt punonjësve të subjekteve përbërëse të grupit, në rastin e shitjes së produktit të tij, ose direkt punonjësit të tij, në rastin e shitjes së produktit të një anëtari tjetër të grupit.

## **7. Ndarja e shërbimeve me subjektet e grupit**

7.1 Institucioni mbizotërues, në rastet kur vendos të ofrojë shërbime për subjektet e tjera të grupit (të tilla si ofrimi i shërbimit të qendëruar të *back-office*, përdorimi i përbashkët i hapësirave fizike, përdorimi i aplikacioneve *hardware* dhe *software*, marrëveshje me të tretët (*outsourcing*) për disa shërbime tek subjekte të tjera financiare të grupit), sigurohet që kjo marrëdhënie:

- a) është qartësisht e dokumentuar në marrëveshje të shkruara, ku përcaktohen llojet e shërbimeve, komisionet/kostot për shërbimin, mënyra e mbrojtjes së të dhënave;
- b) nuk shkakton ngatërresa tek klientët;
- c) nuk dëmton sigurinë dhe qëndrueshmërinë e institucionit mbizotërues si një subjekt i veçantë;
- d) nuk pengon Bankën e Shqipërisë për marrjen e të dhënave që janë të nevojshme për mbikëqyrjen e institucionit mbizotërues, ose të grupit në tërësi;
- e) ka një detyrim të qartë në marrëveshjen e shkruar për çdo ofrues shërbimi, që ai duhet të zbatojë kërkesat e Bankës së Shqipërisë, të cilat lidhen me veprimtarinë e institucionit mbizotërues.

7.2 Institucioni mbizotërues duhet të sigurojë që kapaciteti i tij për të vazhduar veprimtarinë në një mënyrë të qëndrueshme, nuk do të dëmtohet nëse godina apo shërbime të tjera (për shembull sistemet e teknologjisë së informacionit) që ofrohen nga subjekte të tjera të grupit, bëhen të padisponueshme.

7.3 Institucioni mbizotërues duhet të sigurohet që varësia ndaj përdorimit të hapësirës fizike, të shërbimeve, etj., të ofruara nga anëtarët e tjerë të grupit, ose dhënia e shërbimeve të tilla nga institucioni mbizotërues tek anëtarët e grupit, nuk çënon aftësinë e tij për identifikimin dhe administrimin e rrezikut, si një njësi e veçantë.

7.4 Nëse hapësirat e godinës përdoren bashkërisht me subjekte të tjera të grupit, me qëllim shitjen e kryqëzuar të produkteve, institucioni mbizotërues duhet të marra masa për të siguruar që identiteti i subjektit është qartësisht i dukshëm dhe i qartë për klientët.

## **8. Kërkesa raportuese**

8.1 Institucioni mbizotërues raporton në baza tremujore të dhënat mbi TRBG-të, respektivisht:

- a) listën e të gjitha TRBG-ve;
- b) vlerën individuale të çdo TRBG-je dhe vlerën totale të tyre;
- c) vlerën totale të 20 TRBG-ve më të mëdha, brenda grupit.

8.2 Institucioni mbizotërues, për TRBG, duke përfshirë ato të pikën 7 të këtij aneksi “Ndarja e shërbimeve me njësitë e grupit”, raporton në fund të vitit dhe përfshin në raportim një përshkrim lidhur me:

- a) listën e subjekteve/anëtarëve të tjerë të grupit, me të cilët ka patur një TRBG gjatë dy viteve të fundit;
- b) llojin e shërbimit/të marrëdhënies që ka (jep ose merr) me një subjekt tjetër brenda grupit, në fund të periudhës së raportimit;
- c) afatin kontraktual të këtij shërbimi;
- d) detyrimet dhe të drejtat që i lindin nga ky shërbim;
- e) vlerësimin e nivelit të rëndësisë që ka ky shërbim për institucionin mbizotërues;
- f) infrastrukturën që angazhon për këtë shërbim, të klasifikuar të paktën sipasvendndodhjes, numrit të burimeve njerëzore, sistemeve të teknologjisë së informacionit që përfshihen;
- g) të ardhurat ose kostot që lidhen me këtë shërbim;
- h) vlerësimin nëse ky shërbim realizohet sipas kushteve të tregut.

ANEKSI 2

**Pasqyrat financiare mbi baza të konsoliduara (çdo tremujor)**

## Formulari 1: Bilanci mbi baza të konsoliduara

Kodi	AKTIVET (në njësi monetare)	Fondi i Amortizimit dhe provigjonet (-A)	LEKË		VALUTË		TOT.
			Rez.	Jorez.	Rez.	Jorez.	
<b>1</b>	<b>VEPRIMET ME THESARIN DHE TRANSAKSIONET NDËRBANKARE</b>						
<b>11</b>	<b>Arka dhe Banka Qendrore</b>						
<b>111</b>	<b>Arka</b>						
111&2	Monedha metalike dhe kartëmonedha						
1113&4	Çeqet e udhëtarit						
1117	Të tjera						
<b>112</b>	<b>Banka qendrore</b>						
1121	Llogaritë rrjedhëse						
11211	Llogaritë rrjedhëse						
11219	Interesi i përlogaritur						
**I. Llogaritja e kufijve**

Kapitali rregullator i grupit bankar në datën e raportimit = \_\_\_\_\_

Ekspozimi i madh  $\geq 10\%$  e kapitalit rregullator të grupit  $\geq$  \_\_\_\_\_

Ekspozimi i madh i lejuar ndaj personave me marrëdhënie të veçantë 10% e kapitalit rregullator të grupit = \_\_\_\_\_

Kufiri i lejuar i kredive, për dhe në përfitim të personave me marrëdhënie të veçantë 100% e kapitalit rregullator të grupit = \_\_\_\_\_

**II. Tejkalimi i kufirit për ekspozimet e mëdha**

**III. Tejkalimi i kufirit të lejuar të kredive, për dhe në përfitim të, personave me marrëdhënie të veçantë**

Data: \_\_\_\_\_

Vula dhe firma e personit përgjegjës:

## Formulari 5

(Emri i institucionit mbizotërues )

### **EKSPOZIMET NDAJ PERSONAVE ME NJË MARRËDHËNIE TË VEÇANTË**

Data e Raportimit: \_\_\_\_\_

Nr.	Emri	Numri i identifikimit të klientit	Kodi për institucionet financiare ("IF")	Ekspozimi përpara përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë	nga i cili:shuma e KREDIVE	nga i cili: ekspozimi i ardhur nga zëvendësimi	% ndaj kapitalit rregullator të grupit	Mbrojtja e pafinancuar e kredisë	Mbrojtja e financuar e kredisë	Përjashtim e të tjera	Ekspozimi pas përjashtimeve dhe zbutjes së rrezikut të kredisë 11 = 4 - (8+9+10)	% ndaj kapitalit rregullator të grupit	Kufiri
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	
	I. Personat (me marrëdhënie të veçantë)												
	II. Grupe të personave me marrëdhënie të veçantë												

## ANEKSI 5

**Formularët raportues të kapitalit rregullator mbi baza të konsoliduara (referuar rregullores “Për Kapitalin Rregullator” dhe rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”) - (çdo tremujor)**



# Formulari 1

## KAPITALI RREGULLATOR (I KONSOLIDUAR)

Nr.	Zëri	Shuma	Udhëzues
1	<b>KAPITALI RREGULLATOR</b>	1.1 + 1.2	Neni 5: Kapitali rregullator llogaritet si shumë e kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë
1.1	<b>KAPITALI I NIVELIT TË PARË</b>	1.1.1 + 1.1.2	Neni 6: Kapitali i nivelit të parë llogaritet si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë
1.1.1	<b>KAPITALI BAZË I NIVELIT TË PARË</b>	1.1.1.1 + 1.1.1.2 + 1.1.1.3 + 1.1.1.4 + 1.1.1.5 + 1.1.1.6 + 1.1.1.7 + 1.1.1.8 + 1.1.1.9 + 1.1.1.10 + 1.1.1.11 + 1.1.1.12 + 1.1.1.13 + 1.1.1.14 + 1.1.1.15 + 1.1.1.16 + 1.1.1.17 + 1.1.1.18 + 1.1.1.19	Neni 6
1.1.1.1	<b>Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)</b>	1.1.1.1.1 + 1.1.1.1.3 + 1.1.1.1.4 + 1.1.1.1.5	Neni 6, neni 11 dhe neni 16.
1.1.1.1.1	Kapitali i paguar		Neni 6, paragrafi 2, shkronja "a", neni 11. Shuma që do raportohet nuk do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentat.
1.1.1.1.2	Zëra memorandumi: Instrumenta kapitali jo të njohura		
1.1.1.1.3	Primet e aksioneve		Neni 6. Shuma që do të raportohet do të jetë pjesë e lidhur me kapitalin e paguar.
1.1.1.1.4	(-) Instrumenta të veta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë	1.1.1.1.4.1 + 1.1.1.1.4.2 + 1.1.1.1.4.3	Neni 11, shkronja "e", neni 16. Shuma që do raportohet do të përfshijë primet e aksioneve që lidhen me aksionet e veta.
1.1.1.1.4.1	(-) Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në instrumentat e Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë		Neni 11, shkronja "e", neni 16.
1.1.1.1.4.2	(-) Pjesëmarrje të tërthorta në instrumentat e Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë		Neni 11, shkronja "e", neni 16.
1.1.1.1.4.3	(-) Pjesëmarrje sintetike në instrumenta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë		Neni 11, shkronja "e", neni 16.
1.1.1.1.5	(-) Detyrime aktuale ose të mundshme për të blerë instrumenta të veta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë		Neni 11, shkronja "e", neni 16.
1.1.1.2	<b>Fitimet e pashpërdara</b>	1.1.1.2.1 + 1.1.1.2.2 + 1.1.1.2.3	Neni 6, paragrafi 2, shkronja "c", neni 6 paragrafi 8.
1.1.1.2.1	Fitimet e pashpërdara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme		Neni 6 paragrafi 2, shkronja "c".
1.1.1.2.2	Fitimi ushtrimor i fundit të vitit		Neni 6, paragrafi 2, shkronja "d".
1.1.1.2.3	Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese		Neni 6, paragrafi 2, shkronja "e", neni 11 paragrafi 1, shkronja "a"
1.1.1.3	<b>Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)</b>		Neni 6, paragrafi 2, shkronja "f"
1.1.1.4	<b>Diferenca rivlerësimi kreditore</b>		Neni 6, paragrafi 2, shkronja "g"

1.1.1.5	<b>Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë</b>	1.1.1.5.1 + 1.1.1.5.2 + 1.1.1.5.3 + 1.1.1.5.4 + 1.1.1.5.5	Nenet 7-10
1.1.1.5.1	(-) Rritjet në kapital që burojnë nga aktivet e titulluara		Neni 7: Shuma që do të raportohet është rritja në vlerën e kapitalit të bankës që rezultojn nga aktivet e titulluara në përputhje me standardet kontabël. Për shembull, ky zë përfshin të ardhurat e ardhshme nga marzhi që rezultojn nga një fitim nga shitja për bankën, ose për origjinuesin fitimet neto që burojnë nga kapitalizimi i të ardhurave të ardhshme nga aktivet e titulluara që mundësojnë përmirësim të cilësisë së kredisë për pozicionet në titullim.
1.1.1.5.2	Rezerva e mbrojtjes nëpërmjet flukseve të parasë		Neni 8, paragrafi 1, shkronja "a": Shuma që do të raportohet mund të jetë pozitive ose negative. Do të jetë pozitive nëse mbrojtjet nëpërmjet flukseve të parasë rezultojn në humbje (duke reduktuar kështu kapitalin) dhe anasjellas. Pra, shenja e raportuar do të jetë e kundërta e asaj që përdoret në pasqyrat kontabël. Shuma do të jetë neto nga cdo tatim i parashikueshëm në momentin e përlogaritjes.
1.1.1.5.3	Fitimet dhe humbjet e përcaktuara që burojnë nga detyrimet e matura me vlerën e drejtë, si rezultat i ndryshimeve në rrezikun e kredisë të vetë bankës		Neni 8, paragrafi 1, shkronja "b": Fitimet ose humbjet nga detyrimet e bankës që vlerësohen me vlerë të drejtë, që rezultojn nga ndryshimet në vlerësimin e kredisë (credit rating) të vetë bankës. Shuma që do të raportohet mund të jetë pozitive ose negative. Do të jetë pozitive nëse ka humbje si rezultat i ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë (duke reduktuar kështu kapitalin) dhe anasjellas. Pra, shenja e raportuar do të jetë e kundërta e asaj që përdoret në pasqyrat kontabël. Fitimet e paaudituar nuk do të përfshihen në këtë zë.
1.1.1.5.4	Fitime dhe humbje me vlerën e drejtë që burojnë nga rreziku i kredisë së vetë institucionit lidhur me detyrimet derivative		Neni 8, paragrafi 1, shkronja "c" dhe paragrafi 2: c. Fitimet ose humbjet e vlerës së drejtë që burojnë nga rreziku i kredisë së vetë bankës lidhur me detyrimet derivative. Shuma që do të raportohet mund të jetë pozitive ose negative. Do të jetë pozitive nëse ka humbje si rezultat i ndryshimeve në rrezikun e vet të kredisë dhe anasjellas. Pra, shenja e raportuar do të jetë e kundërta e asaj që përdoret në pasqyrat kontabël. Fitimet e paaudituar nuk do të përfshihen në këtë zë.
1.1.1.5.5	(-) Rregullime të vlerës sipas kërkesave për vlerësimin prudent		Neni 9: Në përputhje me nenin 142 "Kërkesa për vlerësimin e zërave të librit të tregtueshëm" të rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit, për të gjitha aktivet e matura me vlerën e drejtë gjatë përlogaritjes së kapitalit rregullator, dhe zbresin nga kapitali bazë i nivelit të parë shumë të çdo rregullimi vlerë shtesë që mund të jetë i nevojshëm.
1.1.1.6	<b>(-) Emri i mirë</b>	1.1.1.6.1 + 1.1.1.6.2 + 1.1.1.6.3	Neni 11, paragrafi 1, shkronja "b" dhe neni 12
1.1.1.6.1	(-) Emri i mirë i klasifikuar si aktiv i patrupëzuar		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "b": Emri i mirë këtu do të ketë të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas standardeve kontabël. Shuma që do të raportohet do të jetë e njëjtë me atë të paraqitur në bilanc.
1.1.1.6.2	(-) Emri i mirë i përfshirë në vlerësimin e investimeve të rëndësishme		Neni 12, paragrafi 2, shkronja "b"
1.1.1.6.3	Detyrimet tatimore të shtyra të lidhura me emrin e mirë		Neni 12, paragrafi 2, pika "a": Shuma e detyrimeve tatimore të shtyra që do të fshiheshin nëse emri i mirë do të zhvlerësohej ose fshihej sipas standardeve kontabël.
1.1.1.7	<b>(-) Aktive të tjera të patrupëzuara</b>	1.1.1.7.1 + 1.1.1.7.2	Neni 11, paragrafi 1, shkronja "b", dhe neni 12, paragrafi 2, pika "a": Aktivet e tjera të patrupëzuara janë aktivet e patrupëzuara sipas standardeve kontabël, minus emrin e mirë, po sipas standardeve kontabël.

1.1.1.7.1	(-) Shuma bruto e aktiveve të tjera të patrupëzuara		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "b": Aktivet e tjera të patrupëzuara janë aktivet e patrupëzuara sipas standardeve kontabël, minus emri i mirë, po sipas standardeve kontabël. Shuma që duhet të raportohet këtu do të korrespondojë me shumën e raportuar në bilanc të aktiveve të patrupëzuara të ndryshme nga emri i mirë.
1.1.1.7.2	Detyrimet tatimore të shtyra të lidhura me aktivet e tjera të patrupëzuara		Neni 12, paragrafi 2, pika "a": Shuma e detyrimeve tatimore të shtyra që do të fshihej nëse aktivet e patrupëzuara të ndryshme nga emri i mirë do të zhvlerësoheshin ose fshiheshin sipas standardeve kontabël.
1.1.1.8	<b>(-) Aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe nuk burojnë nga diferencat e përkohshme, të netuara me detyrimet tatimore të lidhura</b>		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "c" dhe neni 13
1.1.1.9	<b>(-) Aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar</b>	1.1.1.9.1 + 1.1.1.9.2 + 1.1.1.9.3	Neni 11, paragrafi 1, shkronja "d", dhe neni 15
1.1.1.9.1	(-) Shuma bruto e aktiveve të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "d": Aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar përkufizohen si "aktivet e një fondi ose plani pensionesh me përfitim të përcaktuar, të përlogaritura pasi janë zvogëluar me shumën e detyrimeve nën të njëjtin fond ose plan". Shuma që do të raportohet këtu do t'i korrespondojë shumës së raportuar në bilanc (nëse në bilanc raportohet në mënyrë të veçantë).
1.1.1.9.2	Detyrimet e shtyra tatimore të lidhura me aktivet e fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar		Neni 15, paragrafi 2, shkronja "a": Shuma e detyrimeve tatimore të shtyra që do të fshihej nëse aktivet e fondit të pensionit me përfitim të përcaktuar do të zhvlerësoheshin ose fshiheshin sipas standardeve kontabël.
1.1.1.9.3	Aktive të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar, të cilat institucioni ka aftësi të pakufizuar për t'i përdorur		Neni 15, paragrafi 2, shkronja "b": Ky zë do të plotësohet vetëm nëse është marrë miratimi paraprak nga Banka e Shqipërisë për të zvogëluar shumën e aktiveve të fondit të pensionit me përfitim të përcaktuar. Aktivet e përfshira në këtë rresht do të ponderohen me një peshë me rrezik sipas kërkesave të rregullores për mjaftueshmërinë e kapitalit.
1.1.1.10	<b>(-) Pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara në KBN1</b>		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "f" dhe neni 17: Pjesëmarrjet në instrumenta financiare të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku ka një pjesëmarrje reciproke të kryqëzuar të cilën Banka e Shqipërisë e konsideron si të krijuar për të fryrë artificialisht kapitalin rregullator të bankës.  Shuma që do të raportohet do të përlogaritet në bazë të pozicioneve bruto në blerje dhe do të përfshijë zërat e sigurimit (insurance items) të kapitalit bazë.
1.1.1.11	<b>(-) Teprica e zbritjeve nga zërat e Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë që tejkalojnë Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë</b>	(-1.1.2.6)	Neni 11, paragrafi 1, shkronja "i": Shuma që do të raportohet në këtë rresht merret drejtpërdrejt nga rreshti 610 "Teprica e zbritjes nga zërat AT1 mbi kapitalin AT1. Shuma duhet të zbritet nga KBN1.
1.1.1.12	<b>(-) Pjesëmarrjet influencuese (qualifying holdings) jashtë sektorit financiar të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%</b>		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "j", nënpika (i): Sipas nenit 11, paragrafi 1, shkronja "j", pjesëmarrjet influencuese (qualifying holdings) mund të zbriten nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë (duke i raportuar në këtë rresht) ose të ponderohen me 1250%.
1.1.1.13	<b>(-) Pozicionet e titullimit të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%</b>		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "j", nënpika (ii): Pozicionet e titullimit që janë subjekt i ponderimit me një peshë rreziku prej 1250%, por në mënyrë alternative lejohen të zbriten nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë. Në rast se zbriten, do të raportohen në këtë rresht.

1.1.1.14	(-) Transaksione joDVP (free delivery) të cilat (në mënyrë alternative) mund të jenë subjekt i një peshe me rrezik prej 1250%		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "j", nënpika (iii): Transaksionet me dorëzim të lirë janë subjekt i ponderimit me 1250% 5 ditë pas pagesës së dytë kontraktuale ose këmbës së dorëzimit deri në shuarjen e transaksionit, sipas kërkesave të RMK për rrezikun e shlyerjes. Në mënyrë alternative ato mund të zbriten nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë dhe të raportohen në këtë resht.
1.1.1.15	(-) Instrumenta të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "g" dhe neni 18: Pjesa e pjesëmarrjeve të bankës në instrumenta kapitali të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investimet e rëndësishme, që duhet zbritur nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë.
1.1.1.16	(-) Aktive tatimore të shtyra të zbritshme që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "c", neni 13 dhe neni 20, paragrafi 1, shkronja "a": Pjesa e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme (neto nga pjesa e detyrimeve tatimore shoqëruese që i alokohen aktiveve tatimore të shtyra që burojnë nga diferencat e përkohshme, në përputhje me nenin 13, paragrafi 4, shkronja "b") që duhet të zbritet, duke zbatuar kufirin prej 10% të specifikuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja "a".
1.1.1.17	(-) Instrumenta të KBN1 të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "h", neni 19, neni 20, paragrafi 1, shkronja "b", Pjesa e pjesëmarrjeve të bankës në instrumenta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investime të rëndësishme që duhet të zbritet, duke zbatuar kufirin prej 10% të specifikuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja "b".
1.1.1.18	(-) Shuma që tejkalon kufirin prej 17.65%		Neni 20, paragrafi 1: Pjesa e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferencat e përkohshme, dhe pjesëmarrjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të bankës në instrumentat e Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimet e rëndësishme që duhet të zbritet, duke zbatuar kufirin prej 17.65% të specifikuar në nenin 20, paragrafi 1.
1.1.1.19	Interesat e pakicës		Rregullorja "Per Mbiqyrjen e Konsoliduar" Neni 4, shkronja "d" dhe Neni 10, paragrafi 3.
1.1.2	<b>KAPITALI SHITESI I NIVELIT TE PARE</b>	1.1.2.1 + 1.1.2.2 + 1.1.2.3 + 1.1.2.4 + 1.1.2.5 + 1.1.2.6 + 1.1.2.7 + 1.1.2.8	Neni 21
1.1.2.1	Instrumentat e kapitalit të njohura si Kapital Shtesë i Nivelit të Parë	1.1.2.1.1 + 1.1.2.1.3 + 1.1.2.1.4 + 1.1.2.1.5	Neni 21, paragrafi 1, shkronja "a"; Neni 21, paragrafi 2; nenet 22-24; Neni 25 shkronja "a" dhe neni 26
1.1.2.1.1	Instrumenta kapitali të paguara		Neni 21, paragrafi 1, shkronja "a"; Neni 21, paragrafi 2; nenet 22-24; Shuma që do raportohet nuk do të përfshijë Primet e emetimit të lidhura me instrumentat.
1.1.2.1.2	Zë memorandum: Instrumenta kapitali jo te njohura		Neni 22, paragrafi 1, shkronja "c", "e" dhe "f". Kushtet në këto pika pasqyrojnë situata të ndryshme të kapitalit, të cilat janë të kthyeshme, ndaj shuma e raportuar këtu mund të të njihet në periudhat pasuese. Shuma që do raportohet nuk do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentat.

1.1.2.1.3	Primet e emetimit të lidhura me instrumentat		Neni 21, paragrafi 1, shkronja "b". Primet e emetimit të lidhura me instrumentat kanë të njëjtin kuptim sipas standardeve kontabël. Shuma që do të raportohet do të jetë pjesë e lidhur me instrumenta kapitali të paguara.
1.1.2.1.4	(-) Instrumentat e veta të Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë	1.1.2.1.4.1 + 1.1.2.1.4.2 + 1.1.2.1.4.3	Neni 22, paragrafi 1, shkronja "b"; neni 25, shkronja "a" dhe neni 26. Shuma që do të raportohet do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentat që lidhen me instrumentat e veta.
1.1.2.1.4.1	(-) Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në instrumenta të Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë		Neni 22, paragrafi 1, shkronja "b"; neni 25, shkronja "a" dhe neni 26.
1.1.2.1.4.2	(-) Pjesëmarrjet të tërthorta në instrumenta të Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë		Neni 22, paragrafi 1, shkronja "b" pika "ii"; neni 25, shkronja "a" dhe neni 26.
1.1.2.1.4.3	(-) Pjesëmarrjet sintetike në instrumenta të Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë		Neni 22, paragrafi 1, shkronja "b"; neni 25, shkronja "a" dhe neni 26.
1.1.2.1.5	(-) Detyrime aktuale ose të mundshme për të blerë instrumenta të veta të Kapitalit Shtesë të Nivelit të Parë		Neni 25, shkronja "a" dhe neni 26. Sipas neni 25, shkronja "a", "instrumenta të veta të kapitalit shtesë të nivelit të parë, të cilat banka është e detyruar t'i blejë si rezultat i një detyrimi kontraktual" duhet të zbriten.
1.1.2.2	(-) pjesëmarrjet reciproke (të kryqëzuara) në kapitalin shtesë të nivelit të parë (AT1)		Neni 25, shkronja "b" dhe neni 27. Pjesëmarrje në instrumenta të kapitalit shtesë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar kur ka pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) me bankën, të cilat Banka e Shqipërisë vlerëson se janë krijuar për të rritur artificialisht kapitalin e bankës.
1.1.2.3	(-) Instrumentat e kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) të subjekteve të sektorit financiar, ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 25, shkronja "c"; neni 28; neni 29; neni 40. Pjesëmarrje në instrumenta të subjekteve të sektorit financiar, ku banka nuk ka investime të rëndësishme të cilat duhet të zbriten nga kapitali shtesë i nivelit të parë (AT1).
1.1.2.4	(-) Instrumenta e kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) të subjekteve të sektorit financiar, ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 25, shkronja "d"; neni 28; neni 40. Pjesëmarrjet në instrumentat të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) të subjekteve të sektorit financiar, ku banka ka investime të rëndësishme, zbriten plotësisht.
1.1.2.5	(-) tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit të nivelit të dytë (T2) që tejkalojnë kapitalin e nivelit të dytë (T2)	(-1.2.6)	Neni 25, shkronja "e". Shuma që do të raportohet do të merret direkt në zërin "Tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit të nivelit të dytë (T2) që tejkalojnë kapitalin e nivelit të dytë (T2)" (e zbritur në AT1)
1.1.2.6	Tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) që tejkalojnë kapitalin shtesë të nivelit të parë (AT1) (të zbritura në kapitalin bazë të nivelit të parë CET1)		Neni 11, shkronja "i". Kapitali shtesë i nivelit të parë (AT1) nuk mund të jetë negativ, por është e mundur që zbritjet nga AT1 të jenë më të mëdha se kapitali i AT1 plus Primet e emetimit të lidhura me instrumentat që lidhen me to. Në rastet kur ndodh kjo, atëherë AT1 duhet të barazohet me zero, dhe tepricat e zbritjeve nga AT1 duhet të zbriten nga KBN1.
1.1.2.7	(-) Zbritjet shtesë të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1)		Kjo rregullore nuk pengon bankat për të mbajtur më tepër kapital rregulator apo të aplikojë masa më të repta nga sa parashikohen në këtë rregullore.
1.1.2.8	Elemente të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) ose zbritje - të tjera		Ky rresht është vendosur për të siguruar fleksibilitet dhe për qëllime raportimi. Rreshti do të plotësohet vetëm në raste të rralla nëse elementet e kapitali shtesë të nivelit të parë (AT1) apo zbritje të elementeve të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1) nuk do të caktoheshin në rreshtat nga 1.1.2 (kapitali shtesë i nivelit të parë) deri tek rreshti 1.1.2.7 (Zbritjet shtesë të kapitalit shtesë të nivelit të parë (AT1))
1.2	<b>KAPITALI I NIVELIT TE DYTE</b>	1.2.1 + 1.2.2 + 1.2.3 + 1.2.4 + 1.2.5 + 1.2.6 + 1.2.7 + 1.2.8	Neni 30
1.2.1	Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë	1.2.1.1 + 1.2.1.3 + 1.2.1.4 + 1.2.1.5	Neni 30, paragrafi 1, shkronja "a"; neni 31; neni 33, shkronja "a" dhe neni 34.

1.2.1.1	Instrumenta të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur		Neni 30, paragrafi 1, shkronja "a"; neni 31. Shuma që do raportohet nuk do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentat.
1.2.1.2	Zëra memorandumi: Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur jo i njohur		Neni 31, paragrafi 1, shkronja "c", "e" dhe "f". Kushtet në këto pika pasqyrojnë situata të ndryshme të kapitalit, të cilat janë të kthyeshme, ndaj shuma e raportuar këtu mund të të njihet në periudhat pasuese. Shuma që do raportohet nuk do të përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentat.
1.2.1.3	Primet e emetimit të lidhura me instrumentat		Neni 30, paragrafi 1, shkronja "b". Primet e emetimit të lidhura me instrumentat kanë të njëjtin kuptim sipas standardeve kontabël. Shuma që do të raportohet do të jetë pjesë e lidhur me instrumenta kapitali të paguara.
1.2.1.4	(-) Instrumentat e veta të kapitalit të nivelit të dytë (T2)	1.2.1.4.1 + 1.2.1.4.2 + 1.2.1.4.3	Neni 31, shkronja "b", pika (i); neni 33, shkronja "a" dhe neni 34. Shuma që do të raportohet në këtë rresht do përfshijë primet e emetimit të lidhura me instrumentat që lidhen me instrumentat e veta.
1.2.1.4.1	(-) Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta të instrumentave të kapitalit të nivelit të dytë (T2)		Neni 31, shkronja "b"; neni 33, shkronja "a" dhe neni 34.
1.2.1.4.2	(-) Pjesëmarrjet e tërthorta të instrumentave të kapitalit të nivelit të dytë (T2)		Neni 31, shkronja "b"; neni 33, shkronja "a" dhe neni 34.
1.2.1.4.3	(-) Pjesëmarrjet sintetike të instrumentave të kapitalit të nivelit të dytë (T2)		Neni 31, shkronja "b"; neni 33, shkronja "a" dhe neni 34.
1.2.1.5	(-) Detyrim aktual apo i mundshëm për të blerë instrumentat e veta të kapitalit të nivelit të dytë (T2)		Neni 33, shkronja "a" dhe neni 34.
<b>1.2.2</b>	<b>Metoda Standarte (SA) rregullimet kryesore të rrezikut të kredisë</b>		
1.2.3	(-) Pjesëmarrje të kryqëzuara (reciproke) në kapitalin e nivelit të dytë (T2)		Neni 33, shkronja "b" dhe neni 35.
1.2.4	(-) Instrumentat e kapitalit të nivelit të dytë T2 të subjekteve të sektorit financiar, ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 33, shkronja "c"; neni 35; neni 36; neni 37 dhe neni 40.
1.2.5	(-) Instrumentat e kapitalit të nivelit të dytë T2 të subjekteve të sektorit financiar, ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 33, shkronja "d"; neni 35; neni 36 dhe neni 40.
1.2.6	Tepricat e zbritjeve nga zërat e kapitalit të nivelit të dytë (T2) që tejkalojnë kapitalin e nivelit të dytë (T2)		Neni 25, shkronja "e". Kapitali i nivelit të dytë (T2) nuk mund të jetë negativ, por është e mundur që zbritjet nga T2 të jenë më të mëdha se kapitali i T2 plus primet e emetimit të lidhura me instrumentat që lidhen me to. Në rastet kur ndodh kjo, atëherë T2 duhet të barazohet me zero, dhe tepricat e zbritjeve nga T2 duhet të zbriten nga AT1.
1.2.7	(-) Zbritjet shtesë të kapitalit të nivelit të dytë (T2)		Kjo rregullore nuk pengon bankat për të mbajtur më tepër kapital rregullator apo të aplikojë masa më të repta nga sa parashikohen në këtë rregullore.
1.2.8	Elemente të kapitalit të dytë (T2) ose zbritje - të tjera		Ky rresht është vendosur për të siguruar fleksibilitet dhe për qëllime raportimi. Rreshti do të plotësohet vetëm në raste të rralla nëse nuk ka një vendimmarrje finale në raportimin e zerave/zbritjeve specifike të kapitalit. Rreshti do të plotësohet vetëm nëse elementet e kapitali të nivelit të dytë (T2) apo zbritje të elementeve të kapitalit të nivelit të dytë (T2) nuk do të caktohenin në rreshtat nga 1.2 (kapitali i nivelit të dytë) deri tek rreshti 1.2.7 (Zbritjet shtesë të kapitalit të nivelit të dytë (T2))

Shënim sqarues: *“Interes i pakicës” - është shuma (madhësia) e kapitalit bazë të nivelit të parë (aksione të zakonshme) të një anëtarit të grupit bankar, që i atribuohet personave fizikë ose juridikë, të cilët nuk janë objekt i konsolidimit të grupit bankar*

## Formulari 2

### RAPORTET DHE NIVELET E KAPITALIT (I KONSOLIDUAR)

NR.	Zëra	Vlera
1	Raporti: Kapitali Bazë i Nivelit të Parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun.	$\geq 4.5\%$
3	Raporti: Kapitali i Nivelit të Parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun.	$\geq 6\%$
5	Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	$\geq 12\%$

## Formulari 3

ZERA MEMORANDUMI (TE KONSOLIDUARA)			
NR.	Zëri	Shuma	Udhëzues
<b>Aktive dhe pasive tatimore të shtyra</b>			
1	<b>Totali i aktiveve tatimore të shtyra</b>		Shuma e raportuar në këtë rresht do të jetë e barabartë me shumën e raportuar në bilanci kontabël të bankës.
1.1	Aktive tatimore të shtyra të cilat nuk varen nga përfitueshmëria në të ardhmen		Neni 14: Aktivet tatimore të shtyra që nuk varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe janë subjekt i aplikimit të një peshe të caktuar me rrezik.
1.2	Aktive tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen dhe nuk burojnë nga diferenca të përkohshme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "c", dhe neni 13: Aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme por nuk burojnë nga diferenca të përkohshme, dhe nuk janë subjekt i ndonjë zbritjeje kufi (pra zbriten plotësisht nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë).
1.3	Aktive tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen dhe burojnë nga diferenca të përkohshme		Neni 11, paragrafi 1, shkronja "c", neni 13, dhe neni 20, paragrafi 1, shkronja "a": Aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme, dhe si rezultat zbritja e tyre nga Kapitali Bazë i Nivelit të Parë do të jetë subjekt i kufijve prej 10% dhe 17.65% të përcaktuar në nenin 20.
2	<b>Totali i pasiveve tatimore të shtyra</b>	2.1+2.2	Shuma e raportuar në këtë rresht do të jetë e barabartë me shumën e raportuar në bilanci kontabël të bankës.
2.1	Pasive tatimore të shtyra jo të zbritshme nga aktivet tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen		Neni 13, paragrafi 2 dhe 3: Detyrimet tatimore të shtyra për të cilat kushtet në nenin 13, paragrafi 2 dhe 3 nuk përbushen. Në këtë rresht do të përfshihen detyrimet tatimore të shtyra që reduktojnë shumën e emrit të mirë, aktiveve të tjera të patrupëzuara ose aktiveve të fondeve të pensionit me përfitim të përcaktuar që duhet të zbriten.
2.2	Pasive tatimore të shtyra të zbritshme nga aktivet tatimore të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen		Neni 13
2.2.1	Pasive tatimore të shtyra të zbritshme që kanë lidhje me aktive tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen dhe nuk burojnë nga diferenca të përkohshme		Neni 13, paragrafi 2, 3 dhe 4: Aktivet tatimore të shtyra që mund të reduktojnë shumën e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme, sipas nenit 13, paragrafi 2 dhe 3, dhe nuk janë alokuar tek aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme sipas nenit 13, paragrafi 4.
2.2.2	Pasive tatimore të shtyra të zbritshme që kanë lidhje me aktive tatimore të shtyra të cilat varen nga përfitueshmëria në të ardhmen dhe burojnë nga diferenca të përkohshme		Aktivt tatimore të shtyra që mund të reduktojnë shumën e aktiveve tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme, sipas nenit 13, paragrafi 2 dhe 3, dhe janë alokuar tek aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme sipas nenit 13, paragrafi 4.
8	<b>Kufiri i pazbritshëm i pjesëmarrjeve në subjektet e sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme</b>		Neni 18, paragrafi 4, shkronja "a": Në këtë rresht raportohet kufiri deri në të cilin pjesëmarrjet në një subjekt të sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme, nuk zbriten. Pra shuma do të përfshijë zërat që janë në bazë të kufirit shumëzuar me 10%.
9	<b>Kufiri 10% i Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë</b>		Neni 20, paragrafi 1, shkronjat "a" dhe "b": Në këtë rresht raportohet kufiri 10% për pjesëmarrjet në subjektet e sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, dhe për aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme. Shuma përfshin zërat që janë në bazë të kufirit, shumëzuar me 10%.
10	<b>Kufiri 17.65% i Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë</b>		Neni 20, paragrafi 1: Në këtë rresht raportohet kufiri 17.65% për pjesëmarrjet në subjektet e sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, dhe për aktivet tatimore të shtyra që varen nga përfitueshmëria e ardhshme dhe burojnë nga diferenca të përkohshme, që zbatohet pas kufirit prej 10%.  Kufiri përlogaritet në mënyrë të tillë që shuma e dy zërave që njihet të mos tejkalojë 15% të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë, të përlogaritur pas gjithë zbritjeve.
<b>Investimet në kapitalin e subjekteve të sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme</b>			
12	<b>Pjesëmarrje në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje</b>		Neni 17 dhe neni 18



12.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 18
12.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme duke përfshijtur: a) Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për 5 ditë punë ose më pak; b) Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 11, paragrafi 1, shkronja "f".
12.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 18, paragrafi 2 dhe 3: Kompensimi i pozicioneve në shitje me pozicionet në blerje, lejohet kur këto janë në të njëjtin ekspozim themelor dhe maturiteti i pozicionet në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
12.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe Neni 18, paragrafi 2 dhe 3
12.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe Neni 18, paragrafi 2 dhe 3: Shuma që do të raportohet përfaqëson pjesëmarrjet e tërthorta në librin e tregtueshëm të instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letrat me vlerë të indekseve. Kjo shumë përfitohet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në këto indekse. Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje të kryqëzuara reciproke sipas nenit 11, paragrafi 1, shkronja "f" nuk do të përfshihen.
12.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 18, paragrafi 2: Neni 18, paragrafi 2 lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
12.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 18 paragrafi 2 dhe 3
12.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 18 paragrafi 2 dhe 3
12.3.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 18 paragrafi 2 dhe 3
13	<b>Pjesëmarrje në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje</b>	13.1+13.2+13.3	Neni 27; neni 28 dhe neni 29.
13.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	13.1.1+13.1.2	Neni 27; neni 28 dhe neni 29, paragrafi 2.
13.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 29, paragrafi 2. Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar, ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme, duke përfshijtur: a) pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë punë ose më pak; dhe b) pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) sipas nenit 25, shkronja "b"
13.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28
13.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme	13.2.1+13.2.2	Neni 27 dhe neni 28.
13.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 28. Shuma që do të raportohet përfaqëson pjesëmarrjet e tërthorta në librin e tregtueshëm të instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letrat me vlerë të indekseve. Kjo shumë përfitohet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në këto indekse. Pjesëmarrjet që janë trajtuar si pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) sipas nenit 25, shkronja "b" nuk do të përfshihen.

13.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28. Neni 25, shkronja "a" lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
13.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	13.3.1+13.3.2	Neni 27 dhe neni 28.
13.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 28.
13.3.2	(-) Kompensimet e lejuara në pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28.
14	<b>Pjesëmarrje në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje</b>	14.1+14.2+14.3	Neni 35; neni 36 dhe neni 37.
14.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	14.1.1+14.1.2	Neni 35; neni 36 dhe neni 37, paragrafi 2.
14.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 37, paragrafi 2. Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar, ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme, duke përfshirë: a) pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për pesë ditë pune ose më pak; dhe b) pjesëmarrje që trajtohen si pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) sipas nenit 33, shkronja "b"
14.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet të drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36. Neni 36, shkronja "a" lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
14.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve e në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme	14.2.1+14.2.2	Neni 35 dhe neni 36.
14.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 36. Shuma që do të raportohet përfaqëson pjesëmarrjet e tërthorta në librin e tregtueshëm të instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letrat me vlerë të indeksve. Kjo shumë përfshihet duke përfshirë ekspozimin themelor ndaj instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në këto indekse. Pjesëmarrjet që janë trajtuar si pjesëmarrje reciproke (të kryqëzuara) sipas nenit 33, shkronja "b" nuk do të përfshihen.
14.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36. Neni 36, shkronja "a" lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit
14.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme	14.3.1+14.3.2	Neni 35 dhe neni 36.
14.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka nuk ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 36.
14.3.2	(-) Kompensimet e lejuara në pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36.
<b>Pjesëmarrje në Kapitalin e subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme</b>			
15	<b>Pjesëmarrje në Kapitalin bazë të nivelit të parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme</b>	15.1+15.2+15.3	Neni 17 dhe neni 19
15.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin bazë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	15.1.1+15.1.2	Neni 17 dhe neni 19
15.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin bazë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 19: Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, duke përfshirë: a) Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për 5 ditë pune ose më pak; b) Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara

15.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtëpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 19, paragrafi 4 dhe 5: Kompensimi i pozicioneve në shitje për të njëjtin ekspozim themelor mund të kryhet nëse maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti.
15.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme	15.2.1+15.2.2	Neni 17 dhe neni 19, paragrafi 4 dhe 5
15.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 19, paragrafi 4 dhe 5: Shuma që do të raportohet do të përfaqësojë pjesëmarrjet indirekte në librin e tregtueshëm të instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë do të përftohet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në indekse. Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 11, paragrafi 1, shkronja "f" nuk do të përfshihen.
15.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 19, paragrafi 4 dhe 5: Kompensimi i pozicioneve në shitje për të njëjtin ekspozim themelor mund të kryhet nëse maturiteti i pozicionit në shitje përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose ka një maturitet të mbetur prej të paktën një viti.
15.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme	15.3.1+15.3.2	Neni 17 dhe neni 19, paragrafi 4 dhe 5
15.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë në subjektet e sektorit financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 17 dhe neni 19, paragrafi 4 dhe 5
15.3.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 19, paragrafi 4 dhe 5
16	<b>Pjesëmarrje në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje</b>	16.1+16.2+16.3	Neni 27 dhe neni 28.
16.1	Pjesëmarrje të drejtëpërdrejta në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	16.1.1+16.1.2	Neni 27 dhe neni 28.
16.1.1	Pjesëmarrje të drejtëpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 27. Pjesëmarrjet e drejtëpërdrejta në kapitalin shtesë të Nivelit të Parë (AT1) të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, duke përfshiruar: a) Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për 5 ditë punë ose më pak (neni 25, shkronja "d"); b) Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 25, shkronja "b"
16.1.2	(-)Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtëpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28, shkronja "a" lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
16.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme	16.2.1+16.2.2	Neni 27 dhe neni 28.
16.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 28. Shuma që do të raportohet do të përfaqësojë pjesëmarrjet indirekte në librin e tregtueshëm të instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë do të përftohet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në indekse. Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 25, shkronja "b" nuk do të përfshihen.
16.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28, shkronja "a" lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
16.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	16.3.1+16.3.2	Neni 27 dhe neni 28.
16.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 27 dhe neni 28.

16.3.2	(-) Kompensimet e lejuara në pozicionet në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 28.
17	<b>Pjesëmarrje në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, të netuara me pozicionet në shitje</b>	17.1+17.2+17.3	Neni 35 dhe neni 36.
17.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	17.1.1+17.1.2	Neni 35 dhe neni 36.
17.1.1	Pjesëmarrje të drejtpërdrejta (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 35, Pjesëmarrjet e drejtpërdrejta në kapitalin e Nivelit të Dytë (T2) të subjekteve të sektorit financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme, duke përfshirë: a) Pozicionet e nënshkrimit të mbajtura për 5 ditë punë ose më pak (neni 33, shkronja "d"); b) Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 33, shkronja "b"
17.1.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e drejtpërdrejta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36, shkronja "a", lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
17.2	Pjesëmarrje të tërthorta në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve e në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme	17.2.1+17.2.2	Neni 35 dhe neni 36.
17.2.1	Pjesëmarrje të tërthorta (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar në rastin kur banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 36. Shuma që do të raportohet do të përfaqësojë pjesëmarrjet indirekte në librin e tregtueshëm të instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar që kanë formën e pjesëmarrjeve në letra me vlerë të indekseve. Kjo shumë do të përftohet duke përllogaritur ekspozimin themelor ndaj instrumentave të kapitalit të subjekteve të sektorit financiar në indekse. Pjesëmarrjet që trajtohen si pjesëmarrje reciproke të kryqëzuara sipas nenit 33, shkronja "b" nuk do të përfshihen.
17.2.2	(-) Kompensimet e lejuara për pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet e tërthorta (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36, shkronja "a", lejon kompensimin e pozicioneve në shitje në njëjtin ekspozim themelor me kusht që maturiteti i pozicionit në shitje të përputhet me maturitetin e pozicionit në blerje ose të ketë një maturitet të mbetur prej të paktën një vit.
17.3	Pjesëmarrje sintetike në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme	17.3.1+17.3.2	Neni 35 dhe neni 36.
17.3.1	Pjesëmarrje sintetike (BRUTO) në Kapitalin e nivelit të dytë të subjekteve në sektorin financiar ku banka ka investimeve të rëndësishme		Neni 35 dhe neni 36.
17.3.2	(-) Kompensimet e lejuara në pozicione në shitje që kanë të bëjnë me pjesëmarrjet sintetike (BRUTO) të përfshira si më lart		Neni 36.
<b>Shuma totale e rrezikut të ekspozimit të pjesëmarrjeve - që nuk janë zbritur nga kategoria korresponduese e kapitalit</b>			
18	<b>Ekspozimet e pjesëmarrjeve në Kapitalin bazë të nivelit të parë të ponderuara për rrezikun në subjektet e sektorit financiar të cilat nuk janë të zbritura nga Kapitali bazë i nivelit të parë të bankës</b>		Neni 18.
19	<b>Ekspozimet e pjesëmarrjeve në Kapitalin shtesë të nivelit të parë të ponderuara për rrezikun në subjektet e sektorit financiar të cilat nuk janë të zbritura nga Kapitali shtesë i nivelit të parë të bankës</b>		Neni 29.
20	<b>Ekspozimet e pjesëmarrjeve në Kapitalin të nivelit të dytë të ponderuara për rrezikun në subjektet e sektorit financiar të cilat nuk janë të zbritura nga Kapitali i nivelit të dytë të bankës</b>		Neni 37.

## **ANEKSI 6**

**Formularët raportues të pozicioneve të hapura valutore mbi baza të konsoliduara**  
**(referuar rregullores “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura**  
**valutore”) - (çdo tremujor)**

Fomulari 1				
POZICIONI SPOT NË VALUTË				
A. Aktiv	USD	EURO	....	AR
1. Arka dhe Banka Qendrore				
2. Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për refinancim me Bankën Qendrore				
3. Llogari mjedhëse në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare				
4. Depozita në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare				
pa afat				
me afat				
5. Huadhënie bankave, institucioneve të kreditit dhe institucioneve të tjera financiare				
6. Të tjera me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare				
7. Hua dhe paradhënie				
afatshkurtër				
afatmesme				
afatgjatë				
minus provigjonet për kreditë				
8. Detyrime të klientëve për llogaritë mjedhëse				
9. Bono dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse				
10. Bono dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura të ndryshueshme				
11. Interesa pjesëmarrës				
në banka dhe institucione financiare				
në të tjera				
12. Mjete të qëndrueshme të patrupëzuara (neto) (minus amortizimin)				
13. Mjete të qëndrueshme të trupëzuara (neto) (minus amortizimin)				
14. Të tjera aktive				
<b>Totali i Aktivit</b>				
15. Transaksione valutore - blerje valute spot				
pozicioni Spot në Aktiv (Totali i aktivit dhe i transaksioneve valutore - blerje valute spot)				
Pozicioni Spot në Aktiv (kundërvlera në milionë lekë)				
B. Pasivi	USD	EURO	...	AR
1. Banka Qendrore				
2. Llogari mjedhëse nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
3. Llogari mjedhëse në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare				
4. Depozita nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare				
pa afat				
me afat				
5. Hua marrë nga bankat, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare				
6. Detyrime ndaj klientëve për llogaritë mjedhëse dhe depozitat				
depozita				
7. Detyrime ndaj Qeverisë Shqiptare dhe administratës publike				
8. Detyrime nga bonot dhe letra të tjera me vlerë				
minus provigjonet për kreditë				
9. Ndihma dhe financime publike				
10. Fonde rezervë specifike				
11. Buxhi i varur				
12. Kapitali i aksionerëve				
kapitali i paguar				
primet				
13. Të tjera detyrime				
<b>Totali i Pasivit</b>				
14. Transaksione valutore - shitje valute spot				
Pozicioni Spot në Pasiv (Totali i pasivit dhe i transaksioneve valutore - shitje valute spot)				
Pozicioni spot në Pasiv (kundërvlera në lekë)				

Formulari 2					
POZICIONI FORWARD NË VALUTË	USD	EURO	...	AR	TOTALI
<b>C. Pozicioni në blerje (LONG)</b>					
1. Transaksione valutore - blerje valute forward					
2. Transaksione valutore - blerje valute future					
3. Transaksione valutore - kryegjëja sipas marrëveshjeve swap (pjesa e papërfshirë në pozicionin spot)					
4. Garancitë sipas përcaktimit të rregullores					
5. Letër kreditë sipas përcaktimit të rregullores					
Pozicioni forward në blerje (LONG)					
Pozicioni forward në blerje (LONG) (kundërvlera në milionë lekë)					
<b>D. Pozicioni në shitje (SHORT)</b>	USD	EURO	...	AR	TOTALI
1. Transaksione valutore - shitje valute forward					
2. Transaksione valutore - shitje valute future					
3. Transaksione valutore - kryegjëja sipas marrëveshjeve swap (pjesa e papërfshirë në pozicionin spot)					
4. Garancitë sipas përcaktimit të rregullores					
5. Letër kreditë sipas përcaktimit të rregullores					
Pozicioni forward në shitje (SHORT)					
Pozicioni forward në shitje (SHORT) (kundërvlera në milionë lekë)					

Formulari 3					
POZICIONI NETO I OPSIONEVE	USD	EURO	...	AR	TOTALI
1. Blerje opsioni CALL					
2. Shitje opsioni PUT					
3. Shitje opsioni CALL					
4. Blerje opsioni PUT					
Pozicioni neto i opsioneve (1+2)-(3+4)					
Pozicioni neto i opsioneve (kundërvlera në milionë lekë)					


## Formulari 4

POZICIONET E HAPURA VALUTORE	Pozicioni SPOT		Pozicioni FORWARD		Pozicioni neto i hapur valutor (pa përfaqshirë OPSIONET)	Pozicioni neto i OPSIONEVE	Pozicioni neto i hapur valutor (duke përfaqshirë OPSIONET)	Kursi i këmbimit	Ekuivalenti në Lek i pozicionit neto të hapur valutor	Pozicioni neto i hapur valutor në lek / Kapitalit rregullator
	Mbledhje	Detyrimet	Pozicioni në blerje (long)	Pozicioni në shitje (short)						
(1)					(6) = (2) - (3) + (4) - (5)	(7)	(8) = (6) + (7)	(9)	(10)	(11) = (10) / (15) * 100
USD										
EURO										
GBP										
CHF										
CAD										
SEK										
AUD										
JPY										
DKK										
NOK										
TRY										
AR										
1. Pozicioni total neto i hapur valutor në blerje (12)										
2. Pozicioni total neto i hapur valutor në shitje (13)										
3. Pozicioni total neto i hapur valutor i bankës (14) = (12) nëq (13) > (13); ose (13) nëq (13) > (12)										
4. Kapitali rregullator (15)										
5. Pozicioni total neto i hapur valutor i bankës (14) / kapitalit rregullator (15) * 100 = < (30%)										
Norma e miratuar për një monedhë										20%
Norma e miratuar për të gjitha monedhat së bashku										30%



Formulari 5					
Zërat jashtë bilancit (pa elementet e përfshira në pozicionet SPOT, FORWARD dhe Opsionet)					
	USD	EURO	...	AR	TOTALI
<b>F. Aktivi</b>					
1. Angazhime financimi të dhëna					
në favor të bankave dhe institucioneve financiare					
në favor të klientëve					
2. Garanci të dhëna					
në favor të bankave dhe institucioneve financiare					
në favor të klientëve					
3. Angazhime për letra me vlerë për t'u marrë					
4. Letra me vlerë të dhëna si garanci për një kredi ose rfinansim					
5. Letra me vlerë të marra hua					
6. Angazhime të tjera					
7. Angazhime për instrumente financiare të dhëna					
Totali i zërave jashtë bilancit të aktivit					
Totali i zërave jashtë bilancit të aktivit (kundërvlera në milionë lekë)					
<b>G. Pasivi</b>	USD	EURO	CHF	AR	TOTALI
1. Angazhime financimi të marra					
nga bankat dhe institucionet e kreditit					
nga klientët					
2. Garanci të marra					
nga bankat dhe institucionet e kreditit					
nga klientët					
3. Angazhime për letra me vlerë për t'u dhënë					
4. Letra me vlerë të marra si garanci për një kredi ose rfinansim					
5. Letra me vlerë të dhëna hua					
6. Angazhime të tjera					
7. Angazhime për instrumente financiare të marra					
Totali i zërave jashtë bilancit të pasivit					
Totali i zërave jashtë bilancit të pasivit (kundërvlera në milionë lekë)					
H) Zërat jashtë-bilancit neto (kundërvlera në milionë lekë) (F-G)					

Formulari 6				
POZICIONET E HAPURA VALUTORE	Ekivalenti në Lek i pozicionit neto të hapur valutore	Zërat jashtë-bilancit neto	Pozicioni total përfshirë zërat e tjerë jashtë-bilancit	Pozicioni neto i hapur valutore në lek/kapitalit rregullator
Monedha	(1)	(2)	(3)	(4) = '(2) + '(3)
USD				(5)=(4)/(7)*100
EURO				
GBP				
CHF				
CAD				
SEK				
AUD				
JPY				
DKK				
NOK				
TRY				
AR				
1. Pozicioni total neto i hapur valutore në blerje (6)				
2. Pozicioni total neto i hapur valutore në shitje (7)				
3. Pozicioni total neto i hapur valutore i bankës (8) = (6) nqs (6) > (7); ose (7) nqs (7) > (6)				
4. Kapitali rregullator (7)				
5. Pozicioni total neto i hapur valutore i bankës (8)/kapitalit rregullator (7)*100				
Shënime sqaruese:				
Kolona (2): Formulari 4, kolona (10).				
Kolona (3): Formulari 5, shkronja (H).				

Formulari 				
Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e pozicionit të hapur valutore	USD	EURO	...	AR
Shënime sqaruese:				
Formulari 7 plotësohet nga banka sipas përcaktimeve të rregullores.				

## ***ANEKSI 7***

***Formularët raportues për investimet në kapitalin e shoqërive tregtare (referuar rregullores “Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare”) – (çdo tremujor)***

## **Formulari 1**

\_\_\_\_\_  
(Emri i institucionit mbizotërues)

### **RAPORT MBI INVESTIMET NË KAPITAL**

Data e raportimit: \_\_\_\_\_

#### **I. Përlllogaritja e kufijve**

- Kapitali rregullator i grupit bankar në datën e raportimit = \_\_\_\_\_
- Investimi maksimal i lejuar ndaj të njëjtës shoqëri tregtare      15% e kapitalit rregullator të grupit = \_\_\_\_\_
- Investimi maksimal i lejuar i të gjitha investimeve në shoqëritë tregtare,  
të marra së bashku:      60% e kapitalit rregullator të grupit = \_\_\_\_\_

#### **II. Tejkalimi i kufijve**

\_\_\_\_\_

#### **III. Tejkalimi i kufirit për investimet totale, të marra së bashku**

\_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

Përgatitur nga: \_\_\_\_\_

Vula dhe firma e personit përgjegjës:

## **Formulari 2**

(Emri i institucionit mbizotërues)

**Kapitali rregullator i grupit bankar në datën e raportimit**

### **INVESTIMET NË KAPITAL**

Data e raportimit: \_\_\_\_\_

**Tabela 1/1**

Nr.	Emri i subjektit financiar që ka investuar në kapitalin e shoqërive tregtare	Shuma e investuar në kapitalin e shoqërisë tregtare	Emri i shoqërisë tregtare ku është investuar	% e shumës së investuar ndaj kapitalit rregullator të grupit
	1	2	3	4
A.				
B.				
C.				
.....				

**Tabela 1/2**

Nr.	Totali i investimeve në kapitalin e shoqërive tregtare	% e shumës së investuar ndaj kapitalit rregullator të grupit	Kufiri i lejuar në raport me kapitalin rregullator të grupit
	1	2	3
			60%

## **ANEKSI 8**

***Tabelat për publikimin e informacionit (referuar rregullores “Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”)***

## **Formulari 1**

**Tabelë 1: Informacion mbi strukturën, aktivitetin kryesor dhe organizimin e grupit bankar (çdo fund viti)**

<b>1.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi grupin bankar</b>
1.1	Institucioni mbizotërues publikon: <ul style="list-style-type: none"><li>a) Strukturën e subjekteve përbërëse të grupit bankar (në formë skeme);</li><li>b) Formën juridike të subjekteve përbërëse të grupit bankar;</li><li>c) Adresën e subjekteve përbërëse të grupit bankar;</li></ul>
1.2	Institucioni mbizotërues publikon informacion mbi aksionerët që kanë pjesëmarrje influencuese: <ul style="list-style-type: none"><li>a) emrin tregtar ose emrin dhe mbiemrin;</li><li>b) formën juridike,</li><li>c) adresën e regjistruar,</li><li>d) përqindjen e aksioneve me të drejta votimi.</li></ul>
<b>2</b>	<b>Informacion mbi strukturën e funksionimit të grupit bankar</b>
2.1	Institucioni mbizotërues publikon informacion mbi: <ul style="list-style-type: none"><li>a) kodin e etikës dhe politikën e drejtimit të veprimtarisë, në veçanti përmbajtja e ndonjë kodi apo politike qeverisëse dhe procesi i zbatimit të tyre;</li><li>b) politikën e grupit bankar lidhur me konfliktet e interesave, si dhe natyrën dhe nivelin e transaksioneve me subjektet përbërëse të grupit dhe personat/klientët e lidhur.</li></ul>
<b>3.</b>	<b>Informacion mbi aktivitetet e subjekteve përbërëse të grupit bankar</b>
3.1	Institucioni mbizotërues publikon informacion mbi aktivitetin e subjekteve përbërëse si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"><li>a) një listë të veprimtarive sipas licencës së marrë;</li><li>b) një listë të veprimtarive që ato aktualisht kryejnë.</li></ul>



**Tabelë 2: Bilanci kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në veçanti tregues të rentabilitetit (çdo tremujor)**

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës, në formën e analizave dhe komenteve të shkruara, për ecurinë e gjendjes financiare të grupit bankar.
<b>Informacion sasior</b>	
(b)	Bilanci kontabël (aktiv-pasivet) dhe zërat jashtë bilancit, shoqëruar me shënime sqaruese për zërat që i shërbejnë kërkesave të përdoruesve.
(c)	Pasqyra e llogarisë “të ardhura dhe shpenzime”, shoqëruar me shënime sqaruese mbi kategoritë e rëndësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve.
(d)	Tregues të rentabilitetit si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) = të ardhurat neto / aktivet mesatare *100;</li> <li>ii) rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare;</li> <li>iii) shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;</li> <li>iv) kthyeshmëria nga kapitali aksioner mesatar (ROAE) = të ardhurat neto / kapitali aksioner mesatar *100;</li> <li>v) aktive për punonjës = totali i aktiveve/ numri i regjistruar i punonjësve;</li> <li>vi) shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;</li> </ul>

**Tabelë 3: Struktura e kapitalit rregullator** (çdo tremujor)

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës mbi veçoritë kryesore kontraktuale të instrumentave të kapitalit dhe veçanërisht të instrumentave të borxhit të varur.
<b>Informacion sasior</b>	
(b)	<p>Kapitali i nivelit të parë, i llogaritur si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë.</p> <p>i) Kapitali bazë i nivelit të parë, i detajuar në elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kapitali i paguar (aksione të zakonshme);</li> <li>• primet e aksioneve (të zakonshme);</li> <li>• fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme;</li> <li>• fitimi ushtrimor i fundit të vitit;</li> <li>• fitimi ushtrimor i periudhës raportuese;</li> <li>• rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit);</li> <li>• diferenca rivlerësimi kreditore;</li> <li>• interesat e pakicës.</li> </ul> <p>ii) Filtrat prudencialë dhe zbritjet nga kapitali bazë i nivelit të parë sipas rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës” dhe/ose akteve të tjera rregullative.</p> <p>iii) Kapitali shtesë i nivelit të parë, i detajuar në elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• instrumentat e kapitalit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloren “Për kapitalin rregullator të bankës”; dhe</li> <li>• primet e emetimit të lidhura me instrumentat e mësipërm.</li> </ul>
(c)	Totali i kapitalit të nivelit të parë
(d)	<p>i) Kapitali i nivelit të dytë, i detajuar në elementët e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur që plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë;</li> <li>• primet e emetimit të lidhura me instrumentat e mësipërm;</li> </ul> <p>ii) Zbritjet nga kapitali i nivelit të dytë sipas rregullores “Për kapitalin rregullator të bankës”.</p>
(e)	Totali i kapitalit të nivelit të dytë
(f)	Totali i kapitalit rregullator

**Tabelë 4: Mjaftueshmëria e Kapitalit** (çdo tremujor)

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës mbi metodën standarde për vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të grupit bankar.
<b>Informacion sasior</b>	
(b)	Zërat e ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuara me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuara respektivisht në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
(c)	<p>Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut, e llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuara me 12.5.</p> <p>Grupi bankar llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e tregut si shumë e:</p> <p>i) kërkesës për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm, e cila përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kërkesën për kapital për rreziqet e pozicionit;</li> <li>• kërkesën për kapital për rrezikun e përqendrimit; dhe</li> </ul> <p>ii) kërkesës për kapital rregullator për të gjitha pozicionet e grupit bankar (pozicionet në librin e tregtueshëm dhe pozicionet në librat e bankës), e cila përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit;</li> <li>• kërkesën për kapital për rrezikun e pozicioneve në mallra (<i>commodities</i>);</li> <li>• kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes.</li> </ul>
(d)	Kërkesa për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuara me 12.5.
(e)	Raporti i Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë/Aktive të ponderuara me rrezikun (në %).
(f)	Raporti i Kapitalit të Nivelit të Parë/Aktive të ponderuara me rrezikun (në %).
(g)	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (në %).

**Tabelë 5: Informacion i përgjithshëm cilësor për ekspozimin ndaj rreziqeve\***

Informacion cilësor	
(a)	Informacion përmblendhës mbi objektivat dhe politikat e administrimit të secilës kategori rreziku duke u ndalur në veçanti në: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) strategjitë dhe proceset për administrimin e këtyre rreziqeve;</li> <li>ii) strukturën dhe organizimin e funksionit të administrimit të rrezikut/qeve;</li> <li>iii) qëllimin dhe llojet e sistemeve të raportimit dhe matjes së rrezikut/qeve;</li> <li>iv) politikat e zbutjes së rrezikut, strategjitë dhe proceset për monitorimin e vazhdueshëm të efikasitetit të tyre.</li> </ul>

\*Frekuenca e publikimit të informacionit të kërkuar në tabelën 5, do të përshtatet sipas frekuencës së publikimit të secilës kategori rreziku, të detajuar në tabelat në vijim.

**Tabelë 6: Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm (çdo tremujor)**

Informacion cilësor	
(a)	Informacion përmblendhës mbi rrezikun e kredisë që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) përkufizimin e kredive me probleme;</li> <li>ii) përshkrimin e metodës së përdorur për krijimin e fondeve rezervë për humbjet nga kreditë;</li> <li>iii) politikën e grupit bankar për administrimin e rrezikut të kredisë.</li> </ul>
Informacion sasior	
(b)	Teprica bruto e kredisë, teprica mesatare bruto e kredisë gjatë periudhës tremujore, sipas llojeve kryesore të ekspozimeve të kredisë.
(c)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas shpërndarjes gjeografike.
(d)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas sektorëve të ekonomisë ose tipit të kundërpartisë.
(e)	Klasifikime të portofolit të kredive sipas maturitetit të mbetur (kontraktual).
(f)	Shuma e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme sipas klasifikimit (d), dhe shpenzimeve për provigjone brenda këtij klasifikimi.
(g)	Shuma e kredive që u ka kaluar afati dhe atyre me probleme sipas klasifikimit (c), dhe shpenzimeve për provigjone brenda këtij klasifikimi.
(h)	Ndryshimet në fondet rezervë për humbjet nga kreditë gjatë periudhës: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) teprica e fondeve rezervë në fillim të periudhës (+)</li> <li>ii) shtimi i fondeve rezervë (+)</li> <li>iii) rimarrje e fondeve rezervë (+)</li> <li>iv) kreditë e fshira gjatë periudhës (-)</li> <li>v) korrigjime të bëra gjatë periudhës (+ ose -)</li> <li>vi) teprica e fondeve rezervë në fund të periudhës (1+2+3-4+ose-5)</li> </ul>

**Tabelë 7: Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standarde (çdo tremujor)**

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	<p>Informacion përmbledhës për secilën klasë të ekspozimit sipas klasifikimit në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i) emrat e Institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencive të kreditimit të eksporteve (ECA) si dhe arsyet e çdo ndryshimi;</li> <li>ii) klasat e ekspozimit për të cilën është përdorur Institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencia e kreditimit të eksporteve (ECA).</li> </ul>
<b>Informacion sasior</b>	
(b)	<p>Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së kredisë para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, si dhe vlerat e ekspozimeve të zbritshme nga kapitalit rregullator, sipas klasave të ekspozimit në bazë të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.</p>

**Tabelë 8: Teknikat e zbutjes së rrezikut (çdo tremujor)**

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	<p>Informacion përmbledhës mbi teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i) politikat dhe proceset për netimin/kompensimin në bilanc dhe jashtë bilancit, të shoqëruara me të dhëna mbi masën e përdorimit të netimit / kompensimit nga grupi bankar;</li> <li>ii) politikat dhe proceset për vlerësimin dhe administrimin e kolateraleve;</li> <li>iii) përshkrim i kolateraleve kryesore të pranuar nga subjektet e grupit bankar;</li> <li>iv) llojet kryesore të ofruesve të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë dhe të aftësisë së tyre paguese;</li> <li>v) informacione mbi përqendrimin e rrezikut të tregut ose të kredisë brenda instrumentave të përdorura për zbutjen e rrezikut.</li> </ul>
<b>Informacion sasior</b>	
(b)	<p>Vlera e ekspozimit total (neto) pas netimit/kompensimit në bilanc dhe jashtë bilancit (nëse është e aplikueshme) në rastin e përdorimit të mbrojtjes së financuar të kredisë që mbulohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i) kolaterali financiar;</li> <li>ii) netimi në bilanc;</li> <li>iii) marrëveshjet tip të netimit/kompensimit;</li> <li>iv) mbrojtje të tjera të pranueshme.</li> </ul> <p>(pas aplikimit të rregullimeve të luhatshmërisë).</p>

		<p>(c) Vlera e ekspozimit total (neto) pas netimit/kompensimit në bilanc dhe jashtë bilancit (nëse është e aplikueshme) në rastin e përdorimit të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, të mbuluara nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i) garanci;</li> <li>ii) kundërgaranci;</li> <li>iii) derivativët e kredisë.</li> </ul>
--	--	--

**Tabelë 9: Rreziku i kredisë së kundërpartisë (çdo tremujor)**

<b>Informacion cilësor</b>		
	(a)	<p>Informacion përmblendhës mbi derivativët dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë që përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>i) politikat lidhur me sigurimin e kolateralit dhe krijimin e fondeve rezervë për rrezikun e kredisë së kundërpartisë;</li> <li>ii) shumën e fondeve rezervë që grupi krijon/planifikon, në rastet kur vlera e kolateralit bie për shkak të rënies së cilësisë së kredisë (<i>downgrading</i>).</li> </ul>
<b>Informacion sasior</b>		
	(b)	i) vlera e drejtë pozitive bruto e kontratave;
		ii) zvogëlimi i vlerës së drejtë pozitive bruto si rrjedhojë e netimit / kompensimit;
		iii) vlera e drejtë pozitive neto e marrëveshjeve të netimit / kompensimit;
		iv) garancitë e marra;
		v) vlera e drejtë pozitive e kontratave derivative neto pas aplikimit të netimit / kompensimit dhe marrëveshjeve të garancisë;
		vi) vlera e ekspozimeve ndaj rrezikut të kundërpartisë, të llogaritura sipas metodës standarde;
		vii) vlera nominale ( <i>notional</i> ) e derivativëve të kredisë të përdorur për mbulimin e rrezikut të kundërpartisë;
		viii) shpërndarja e vlerës së drejtë pozitive të kontratave, sipas llojit të kontratave derivative;
		ix) vlera nominale ( <i>notional</i> ) e derivativëve në librin e bankës dhe në librin e tregtueshëm, të ndarë sipas produkteve dhe të detajuar sipas pozicionit që merr grupi (blerës ose shitës i mbrojtjes) në fushën e secilit grup produktesh;

**Tabelë 10: Titullzimi (çdo tremujor)**

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës mbi titullzimin (përfshirë këtu dhe titullzimin sintetik) që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) objektivat e grupit bankar mbi veprimtarinë e titullzimit duke përfshirë shkallën me të cilën këto veprimtari transferojnë rrezikun e kredisë të aktivitetit bazë të titullzuar, nga subjektet e grupit bankar në subjekte të tjera;</li> <li>ii) roli që luajnë subjektet e grupit bankar në procesin e titullzimit dhe shkalla e përfshirjes së tyre në secilin proces titullzimi.</li> </ul>
(b)	Informacion përmbledhës mbi politikat kontabël të përdorura nga grupi bankar për operacionet e titullzimit që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) nëse transaksionet trajtohen si shitje ose financime;</li> <li>ii) njohjen e fitimeve nga shitja;</li> <li>iii) supozimet bazë për vlerësimin e interesave të përfuturshme që përfshijnë çdo ndryshim të rëndësishëm që nga periudha e fundit raportuese dhe ndikimi i këtyre ndryshimeve;</li> <li>iv) trajtimin e titullzimeve sintetike nëse nuk mbulohen nga politika të tjera kontabël (për shembull derivativët).</li> </ul>
(c)	Emrat e Institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) të përdorura për titullzimin dhe llojet e ekspozimeve në titullzime për të cilat është përdorur secili institucion.
<b>Informacion sasior</b>	
(d)	Shuma totale e operacioneve të titullzimit të realizuara nga grupi bankar në rastet kur grupi bankar është origjinues i titullzimit, të ndara në titullzime tradicionale dhe sintetike dhe të atyre (operacioneve të titullzimit) në të cilat grupi bankar është investues, sipas llojit të ekspozimit.
(e)	Për ekspozimet e titullzuara nga grupi bankar dhe subjekt i kuadrit rregullativ për titullzimin, sipas llojit të ekspozimit: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) shuma e aktiveve të titullzuara me probleme; dhe</li> <li>ii) humbjet e njohura nga grupi bankar në periudhën aktuale.</li> </ul>
(f)	Shuma agregate e ekspozimeve të mbajtura ose të blera në titullzime, të ndara sipas llojit të ekspozimit.
(g)	Informacion mbi vlerën agregate të ekspozimeve që i atribuohet interesave të origjinuesve dhe investitorëve në rastet e lehtësirave të titullzuara, që janë subjekt i trajtimit të shlyerjes së parakohshme.
(h)	Shuma e operacioneve të titullzimit për vitin aktual duke përfshirë shumën e ekspozimeve të titullzuara sipas llojit të ekspozimit dhe njohja e humbjeve ose të fitimeve nga shitja, sipas llojit të aktivitetit.
(i)	Shuma e pozicioneve të titullzimit të zbritura nga kapitali rregullator ose ato të cilat ponderohen me peshën e rrezikut 1250 %.

**Tabelë 11: Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm (çdo gjashtëmuajor)**

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës cilësor, për rreziqet e tregut sipas kërkesave të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
<b>Informacion sasior</b>	
(b)	Kërkesa për kapital për:
	<ul style="list-style-type: none"> <li>i) rrezikun nga normat e interesit;</li> <li>ii) rrezikun nga pozicionet në instrumentat e kapitalit;</li> <li>iii) rrezikun nga kursi i këmbimit;</li> <li>iv) rrezikun e pozicioneve në mallra (<i>commodities</i>).</li> </ul>

**Tabelë 12: Rreziku operacional (çdo tremujor)**

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës për metodën e përdorur në vlerësimin e rrezikut operacional (Metoda e Treguesit të Thjeshtë ose Metoda Standarde).
<b>Informacion sasior</b>	
(b)	Kërkesa për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuar në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të shumëzuar me 12.5.

**Tabelë 13: Rreziku i likuiditetit (çdo tremujor)**

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës për kushtet e marrëveshjes, në rastet e ekzistencës së një marrëveshje brenda grupit, për mbështetje me likuiditet.

**Tabelë 14: Politikat kontabël (çdo fund viti)**


<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës mbi politikat kontabël të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare, në mënyrë që përdoruesi i informacionit të njohë si vlerësohen zërat e ndryshëm në këto pasqyra, për një interpretim të saktë të informacionit.
(b)	Informacion përmbledhës mbi politikat kontabël të përdorura për vlerësimin e aktiv - pasiveve, fondeve rezervë, të ardhurave etj.



**Tabelë 15: Politikat e shpërblimit** (çdo fund viti)

<b>Informacion cilësor</b>	
(a)	Informacion përmbledhës mbi njësinë përgjegjëse që përcakton politikat e shpërblimit të subjekteve të grupit bankar, që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) emrin, përbërjen dhe mandatin e njësisë përgjegjëse për përcaktimin e politikave të shpërblimit;</li> <li>ii) një përshkrim të qëllimit të politikave të shpërblimit të grupit bankar (për shembull sipas linjave të biznesit);</li> <li>iii) një përshkrim për kategorinë e punonjësve që ndërmarrin rrezik në detyrat që kryejnë si dhe drejtuesit ekzekutivë, duke përfshirë dhe numrin e punonjësve në secilin grup.</li> </ul>
(b)	Informacion përmbledhës në lidhje me hartimin dhe strukturimin e procesit të përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) objektivat e politikave të shpërblimit;</li> <li>ii) rishikimin e politikave të shpërblimit gjatë vitit të kaluar (nëse ka), shoqëruar me një përshkrim të ndryshimeve që janë bërë;</li> <li>iii) procedurën e ndjekur nga subjektet e grupit bankar për të siguruar se politikat e shpërblimit të punonjësve që ndërmarrin rrezik në detyrat që kryejnë, dallojnë nga pjesa tjetër e punonjësve të grupit.</li> </ul>
(c)	Informacion përmbledhës mbi procedurat e subjekteve të grupit bankar për vlerësimin e ndikimit të rrezikut aktual dhe rrezikut <i>ex-ante</i> në përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve, që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) rreziqet që subjektet marrin në konsideratë gjatë procesit të zbatimit të masës së shpërblimit;</li> <li>ii) masat kryesore të përdorura për të vlerësuar rreziqet, përfshirë këtu dhe rreziqet e vështira për t'u matur, si dhe ndikimin e tyre në politikat e pagave dhe shpërblimeve.</li> </ul>
(d)	Informacion përmbledhës mbi mënyrën sesi subjektet e grupit bankar lidhin performancën me nivelin e pagave dhe shpërblimeve, që përfshin: <ul style="list-style-type: none"> <li>i) matësit kryesorë të performancës për subjektet përbërëse të grupit, për linjat kryesore të biznesit dhe për punonjësit;</li> <li>ii) masën (në %) e shpërblimit individual që varet nga performanca e përgjithshme e subjekteve të grupit bankar dhe performanca individuale e çdo punonjësi;</li> <li>iii) masat që ndërmerren për të përshtatur politikat e shpërblimit, në rastet e performancës financiare negative.</li> </ul>
(e)	Informacion përmbledhës mbi mënyrën sesi lidhen objektivat dhe performanca në periudhën afatgjatë, me nivelin e pagave dhe shpërblimeve.
(f)	Informacion përmbledhës mbi format e ndryshme të elementit të ndryshueshëm të shpërblimit që përdoren dhe arsyen e përdorimit të tyre. Një përshkrim nëse ky element i ndryshueshëm i shpërblimit ndryshon për punonjës apo grup punonjësish të caktuar, një përshkrim të faktorëve që përcaktojnë kombinimin e shpërblimit të ndryshueshëm dhe rëndësinë e secilit prej tyre.
<b>Informacion sasior</b>	
(g)	Numrin e takimeve të mbajtura nga struktura përgjegjëse për përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve gjatë vitit financiar dhe niveli i pagesës së anëtarëve të kësaj strukture.

(h)	Shumat vjetore të agreguara të pagesave dhe shpërblimeve për këshillin drejtues dhe/ose organet drejtuese dhe drejtuesit ekzekutivë (sipas tabelës 16), si dhe format e shpërblimit të tyre, duke argumentuar dhe shpjeguar përputhshmërinë e këtyre pagesave me politikat e administrimit të rrezikut, profilin e rrezikut të përcaktuar sipas objektivave afatgjatë të grupit bankar.
-----	---

**Tabelë 16\*\***  format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe/ose organet drejtuese dhe drejtuesit ekzekutivë të të gjithë subjekteve të grupit bankar (çdo fund viti)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale	Për periudha të kaluara
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit		
<i>Cash/bonus</i>		
<i>aksione</i>		
<i>të tjera</i>		
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit		
<i>Cash/bonus</i>		
<i>aksione</i>		
<i>të tjera</i>		

\*\* Kjo tabelë do të plotësohet më vete për a) Këshillin Drejtues dhe/ose organet drejtuese dhe b) drejtuesit ekzekutivë të të gjithë subjekteve të grupit bankar.